

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7767 E premte 18 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga PËLLUMB KARAMETA



Unë nisem nga postulati se jemi në pragun e një shndërrimi madhor me natyrë të ngjashme me shndërrimet që bënë të lindnin shkolla, arsimi publik ...
Vijon në faqen 20

Zhvillimet e teknologjisë digjitale në arsim

Opinion i Ditës

Nga ANDI BUSHATI



Opozita ka gjetur një sebeb qe-sharak, si mosdhënia e fjalës në parlament gjatë votimit të ministrave të rinj, për të shpallur një aksion madhor: protesta ...
Vijon në faqen 21

Mirë protesta, por cili është fundi?



17 vite në gjyq për hotelin luksoz në Sarandë

Balili mbetet në qeli, ja historia e ish-kampit që u bë "Santa Quaranta"

Bashkim Balili bleu 60% të pronës për 84 mln lekë. "Keli" i akuzuar për trafik, i buzëqeshur në gjykatë

Që në vitin 2017, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe policia kanë vendosur nën sekuestro hotelin "Santa Quaranta" në Sarandë, pronë e familjes Balili. Resorti turistik, i ngritur mbi godinën e rrrënuar të ish-kampit të punëtorëve në Sarandë, u inaugurua me bujë nga politikanë ...

Ne faqet 2-3

INTERVISTA/ SKANDALI ME UNAZEN E RE, PRESIDENTI: PROJEKT JOTRANSPARENT

META: S'E KAM TAKUAR BALILIN. PSE NUK E DEKRETOVA ÇAKAJN

Kreu i shtetit, i ftuar në "News 24": Unë në krye të opozitës? Deri më 24 korrik 2022 jam në detyrë. Ministrat e rinj betohen në Presidencë, mungon Rama



(Në foto) Presidenti Ilir Meta, në emisionin "Të Paekspozuarit" në "News 24"

Ne faqen 5

EMRAT/ 12 NE KERKIM

Mashtrimi me TVSH, 18 milionë euro gropë në buxhet, 13 veta në pranga

Ne faqen 8

PENSIONET

Kolë Nikollaj: 10 mijë punonjës në miniera, vetëm 2 mijë paguajnë kontribut suplementar

Ne faqet 10-11

MISTERI

Atentati në Korçë, 30-vjeçari vritet me plumb në kokë pas sherrit në lokal

Ne faqen 8

HISTORIA

Grëfimi i veçantë për diktaturën, Bardha Mëlyshi: 7 vjeçe në kamp internimi

Ne faqen 19

PRESIDENTI I RUSISE



Putin në Beograd: Kosova destabilizon. Vuçiç: Çdo zgjidhje do kalojë nga Moskë

Ne faqen 16

Procedura dhe dokumentet që nevojiten për të marrë dëmshpërblimin financiar

Të përndjekurit, dokumentet për këstin e 10

Rradha e ndarjes së parave, në fillim gratë dhe personat mbi 75 vjeç

Ministria e Financave ka nisur dhënien e këstit të dhjetë për kategori të parësore, që janë pjesë e skemës së dëmshpërblimit si ish-të dënuar politikë. Urdhri i ri parashikon procedurat, dokumentet dhe radhën si do jepen paratë për këstin e 10-të me fondin e ri që Ministria e



Financave ka në dispozicion për vitin 2019. NJOFTIMI I PLOTE Në zbatim të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007. "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 419, datë 14.04.2011 ...

Ne faqen 13

TRAFIKU I DROGES "ESKOBARI"

Konflikti 17-vjeçar mes Bashkim Balilit dhe Sindikatës së Pavarur të Ushqimit

Si u tjetërsua kampi i Sarandës në kompleksin luksoz të Balilit

Vëllai i "Kelit" bleu 60% për 84 milionë lekë

Lindita Çela

Që në vitin 2017, Prokuroria e Kri meve të Rënda dhe policia kanë vendosur nën sekuestro hotelin "Santa Quaranta" në Sarandë, pronë e familjes Balili. Resorti turistik, i ngritur mbi godinën e rrënuar të ish-kampit të punëtorëve në Sarandë, u inauguroi me bujë nga politikanë të lartë të mazhorancës në gusht 2015 dhe u quajt "një investim serioz i jashtëzakonshëm". Megjithatë, dokumentet e siguruar nga BIRN tregojnë se shkëlqimi i hotelit "Santa Quaranta" u ngrit mbi një konflikt gjyqësor 17-vjeçar për pronësinë mes Bashkim Balilit dhe një sindikate të vogël, të quajtur Sindikata e Pavarur e Ushqimit. Ish-kampi i punëtorëve në Sarandë është vetëm një prej shumë pronave të trashëguara nga regjimi komunist, që përmes një dekreti të presidentit të kohës u kaluan sindikatave në fillim të viteve '90. Njësoj si shumica e tyre, edhe ish-kampi i Sarandës u përfshi në një transformim të paligjshëm pronësie, konflikti i të cilit vazhdon sot e kësaj dite në dyert e gjykatave. Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Ushqimit, Maksim Mbelli i tha BIRN se e kishte përfutur pronën përmes një akti dhurimi të vitit 1997 nga Bashkimi i Pavarur i Sindikatave të Shqipërisë. Mbelli kujton se mbeti i shtangur në gusht 2015, kur pa në televizor drejtues të lartë të shtetit t'i thurnin lavdë investimit mbi një pronë, që ai pretendon se i takon sindikatës së drejtuar prej tij. "Në vitin 2011, unë kam marrë një vendim gjykatë të formës së prerë dhe atë e kam çuar në hipotekë. Unë nuk di se si mund të përurohet një pronë, ndërkohë që ajo rezultoi e regjistruar në emër të sindikatës. Nuk e kuptoj



Klement Balili



Hoteli "Santa Quaranta", në Sarandë

dot", tha Mbelli për BIRN. Dokumentet e proceseve gjyqësore dhe të një hetimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit tregojnë se para se të firmoste dhurimin tek sindikata vertikale, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë kishte krijuar një shoqëri aksionere të quajtur "Dea", sh.p.k, së bashku me një kompani italiane, ku aksionet ndaheshin 40% për BSPSH dhe 60 për qind për italianët. Ish-kampi i punëtorëve në Sarandë kaloi gjithashtu si objekt i kësaj kompanie.

Kundërshtar i Mbellit në

këtë çështje, Bashkim Balili pretendon sipas padvive të dorëzuara në gjykatë se 60 për qind të pronës e kishte blerë në ankand në vitin 2000 dhe për pjesën tjetër kishte një kontratë afatgjatë qiraje me Bashkimin e Pavarur të Sindikatave.

Veprimet e dyfishta juridike nga zyrtarët e BSPSH së asaj kohe përbëjnë edhe zanafillën e konfliktit gjyqësor të pronësisë, që ndodhet aktualisht në Gjykatën e Lartë. I kontaktuar nga BIRN, kryetari i Bashkimit të Pavarur të Sindikatave të Shqipërisë, Gëzim Kalaja,

DOSJA, PEZULL QE NGA 2012

Që prej vitit 2012, çështja është në pritje të gjykohe në Gjykatën e Lartë. E pyetur nga BIRN në 2017-ën, zëdhënësja e Gjykatës së Lartë tha se shqyrtimi i çështjes është shtyrë për shkak të mosplotësimit të kuorumit të trupës gjyqësore.

nuk iu përgjigj pyetjeve mbi pronësinë e ish-kampit të punëtorëve në Sarandë. Zyra juridike e BSPSH i ofroi BIRN dokumente të pjesshme, për të mbështetur pretendimin se si dhurimi i ish-kampit të Sindikatave të Pavarur e Ushqimit, ashtu edhe kontrata e qirasë me kompaninë e Bashkim Balilit nuk janë nënshkruar nga kryetari aktual, Kalaja. Maks Haxhia, avokati i Bashkim Balilit në këtë çështje nuk iu përgjigj gjithashtu pyetjeve të BIRN.

NDRYSHIMI I PRONËSISË

Dokumentet e siguruar nga BIRN tregojnë se pas



Klement Balili, duke dalë nga Drejtoria e Policisë së Tiranës

mi në hipotekë tregojnë se fillimisht prona i ka kaluar shoqërisë "DEA", e cila zotërohej në 60 për qind nga kompania italiane "Mare Monti Holding" dhe 40 për qind nga BSPSH, me premtimin se në të do të investoheshin 100 mijë dollarë. Të dhënat e siguruar në Hipotekën e Sarandës nga Kontrolli i Lartë i Shtetit tregojnë pronësinë e ish-kampit të Sarandës i ka kaluar kompanisë "DEA" me firmë të sekretarit të përgjithshëm të BSPSH, Fatmir Musaku.

Në vitin 1996 italianët i shitën kuotat e tyre, ndërsa 60 për qindëshi i kompanisë kaloi në dy duar derisa përfundoi tek firma piramidale "Kamberi", së bashku me një kontratë qiraje prej 25 vjetësh për pjesën tjetër të ish-kampit. Dokumentet tregojnë se në vitin 2000, Bashkim Balili e ka blerë 60 për qind të pronës në ankand për rreth 84 milionë lekë,

ndërkohë që ka lidhur kontratën e qirasë për pjesën takuese të Bashkimit të Pa-

ur të Ushqimit në maj 1997. Ky akt dhurimi është reflektuar në regjistrat e Hipotekës së Sarandës në maj të vitit 2000. Në qershor 2000, pasi kishte dështuar të regjistronte kontratën e qirasë në hipotekë, kompania "Titan Konstruksion" e Bashkim Balilit ka paditur në Gjykatën e Sarandës Sindikatën e Pavarur të Ushqimit, me objekt "deklarimin e pavlefshëm të kontratës së dhurimit". Argumenti kryesor i padisë ishte fakti se Bashkimi i Pavarur i Sindikatave nuk mund të falte ish-kampin e pushimit, pasi ishte pronarë në vetëm 40 për qind të tij. Në një seancë të vetme, trupi gjyqësor i kryesuar nga Petrit Aliaj vendos në favor të kompanisë "Titan Konstruksion" dhe urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të regjistrojë kontratën e qirasë në favor të Balilit.

Pesë vite më vonë, në mars 2005, një vendim i Gjykatës së Apelit të Gjirokastrës vendos të rrezojë vendimin e shkallës së parë, duke e kaluar të drejtën sërish në krah të Sindikatës së Pavarur të Ushqimit. "Na u dëshën 5 vite gjyq vetëm që të legjitimoheshim dhe më pas filloi shqyrtimi i çështjes në themel", tregon Mbelli.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, "Titan Konstruksion" bëri rekurrs në Gjykatën e Lartë dhe fitoi. Në vitin 2008, edhe Gjykata Kushtetuese rrëzoi padinë e Sindikatës së Pavarur të Ushqimit. Por, procesi u rihap sërish në prill të vitit 2011, pasi Gjykata e Lartë legjitimoi si provë të re një hetim të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili vlerësoi se pronësia e ish-kampit të punëtorëve ishte transformuar në kundërshtim me ligjin.

Ç'THA VETE BALILI

"Unë nuk kam lidhje me atë hotel, me atë pronë që më akuzojnë. Është shumë e lehtë që të verifikohet kjo, mjafton që të shihen dokumentet e pronësisë. Unë nuk kam lidhje fare me atë pronë", tha Keli në një intervistë për Artan Hoxhën.

përfitimt të pronës, zyrtarët të ndryshëm të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë kishin kryer veprime të kundërta të fatin e mëpasshëm të ish-kampit të lakmuar të pushimit në Sarandë. Të dhënat nga paditë gjyqësore dhe verifiki-

varur të Sindikatave për 25 vjet. Më parë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, përmes një sekretari tjetër të Përgjithshëm të quajtur Xhevdet Llubani kishte firmosur aktin e dhurimit të ish-kampit të punëtorëve në dobi të Sindikatës së Pavar-



TIRANË

Klement Balili, i cili për më shumë se dy vite sfidoi nga arratia institucionet ligjzbatuese, dje doli i qeshur nga qelia ku mbahej dhe po ashtu u shfaq i qeshur në kafazin e xhamtë të Gjykatës për Krime të Rënda, ku dhe u zhvillua seanca gjyqësore për verifikimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" marrë në mungesë për të. 46-vjeçari i ashtuquajtur si "Eskobari i Ballkanit", "Baroni i drogës", "Peshku i madh" apo "Magjistari" nisi kështu betejën e tij me drejtësinë shqiptare. Ish-drejtori i Transporteve të Sarandës doli përpara gjykatëses Miliana Muça, për t'u njohur me masën e sigurisë dhe katër akuzat zyrtare, që Prokuroria për Krime të Rënda ka ngritur pas dy vitesh hetime ndaj tij. Biznesmeni që deri dje ishte në toplotën e të kërkuarve të drejtësisë shqiptare, akuzohet për "Trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, në bashkëpunim", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash", të cilat ai i ka mohuar me forcë gjatë procesit. Klement Balili ka deklaruar para gjyqtarës Muça se është i pafajshëm në lidhje me katër veprat penale që rëndojnë mbi të. Ndërkohë, dy avokatët e tij mbrojtës, Theodhori Sollaku dhe Baftjar Rusi kanë sqaruar se për episodin, për të cilin e akuzon prokuroria, klienti i tyre nuk ka lidhje. Sipas tyre, përgjimi i

Avokatët: Nuk ka asnjë provë që të jetë përfshirë në trafik droge

Klement Balili "sfidon" dhe Krimet e Rënda, shfaqet i buzëqeshur në kafazin e xhamtë

Gjykata e lë në burg, i ashtuquajtur "Magjistari" dhe "Eskobari i Ballkanit: Jam i pafajshëm



Klement Balili dje te Krimet e Rënda



Gjyqtarja Miliana Muça

AKUZAT NDAJ BALILIT

Klement Balili u dorëzua mëngjesin e së martës pas 3 muaj negociatash mes drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe nipit të tij, Rigers Balili, me detyrë kryetar i Bashkisë së Delvinës. Por, pavarësisht vetëdorëzimit edhe në prani të njërit prej familjarëve të tij, policia pretendon se 46-vjeçari nuk e përballoi dot presionin dhe rrethimin policor, të paktën gjatë dy muajve të fundit. 46-vjeçari akuzohet për "Trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, në bashkëpunim", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash".

PËRGJIMET

Klement Balili do të qëndrojë në burg deri në përfundim të gjykimit. Gjykata e Krimeve të Rënda i ka komunikuar Balilit dje masën e sigurisë dhe akuzat. Provë më të fortë prokuroria ka përgjimit që e implikojnë në trafikun e drogës. Kur gjyqtarja Miliana Muça u ul në sallë, Balili vendosi t'u përgjigjej kërkesave nga gjykata. Ai tha se ka zgjedhur dy avokatë Theodhori Sollaku dhe Baftjar Rusi, por nuk dha shpjegime për sa kohë ishte media e pranishme në sallën e gjyqit.

kryer nuk faktin se në këtë rast kemi të bëjmë me Klement Balilin. Pavarësisht mohimit të akuzave, trupi gjyqësor la të pandryshuar masën e sigurisë, pra lënien e tij në qeli.

BATUTAT ME GAZETARËT

Teksa gjykatësja Miliana Muça u tërhoq në dhomën e këshillimit, Balili qëndroi i qetë në pritje të vendimit. Këto momente u shfrytëzuan nga gazetarët për të shkëmbyer batuta me të. Ai shkëmbeu edhe batuta me gazetarët. I pyetur nëse kishte prova kompromentuese për politikanët, siç ka deklaruar ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, Klement Balili prej kafazit të xhamtë deklaroi se nuk disponon asnjë material të tillë. "Nëse Manjani ka prova të tilla, le t'i nxjerrë, unë nuk kam", është shprehur Balili.

GJYQI

Seanca gjyqësore, e cila ngjalli interesin e madh të medias, ishte e hapur vetëm në momentet e para, përgjatë të cilave i pandehuri nuk bëri asnjë koment. Seanca zgjati për 50 minuta. Në vijim, gjykata i mbylli dyert me kërkesën e prokurorit Ened Nakuci, i cili u shfaq në sallën e gjyqit i mbrojtur nga forcat speciale. Autoritetet nuk bënë të ditur arsyet e shtimit të masave të sigurisë personale për prokurorin. Burimet thanë se gjatë seancës prokurori kërkoi mbajtjen në burg të Klement Balilit, ndërsa renditi të gjitha provat e fajësisë kundër ish-zyrtarit të lartë. Kryesisht bëhet fjalë për përgjime telefonike dhe dëshmi të ardhura nga Greçia. Por, akuzat janë kundërshtuar nga i pandehuri. Përmes avokatëve mbrojtës, ai tentoi të binte gjykatën që të zbuste masën e sigurisë, duke përdorur si argument thelbësor faktin se është vetëdorëzuar dhe nuk ka më asnjë interes për t'ju shmangur drejtësisë. E ndërsa debatohej ashpër në sallën e gjyqit, në ambientet

e jashtme të gjykatës, jashtë dverve të institucionit qëndronin familjarët e personazhit të shumëpërfolur, në mbështetje të tij. Teksa gjykatësja Miliana Muça u tërhoq në dhomën e këshillimit, Balili qëndroi i qetë në pritje të vendimit. Këto momente u shfrytëzuan nga gazetarët për të shkëmbyer batuta me të. Ai shkëmbeu edhe batuta me gazetarët. I pyetur nëse kishte prova kompromentuese për politikanët, siç ka deklaruar ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, Klement Balili prej kafazit të xhamtë, deklaroi se nuk disponon asnjë material të tillë. "Nëse Manjani ka prova të tilla, le t'i nxjerrë, unë nuk kam", është shprehur Balili. Nuk vonoi që gjykatësja Miliana Muça të dilte për të shpallur vendimin, sipas të cilit, la në fuqi masën e sigurisë "Arrest me burg", pasi argumentet e avokatëve mbrojtës ishin të pabazuara. Pas vendimit të gjykatës, Balili u transferua në një qeli paraburgimi, ku do të qëndrojë i vetëm për arsye sigurie. Ndërkaq, jashtë dverve të gjykatës, avokati Theodhori Sollaku relativizoi

punën e prokurorisë, teksa deklaroi se nuk ka prova kundër të mbrojturit prej tij. "Nuk ka asnjë provë, direkte, indirekte apo indicie që Klement Balili është përfshirë në trafikimin e 670 kg lëndësh narkotike e kapur në ishullin Zakintos", u shpreh Sollaku. Sikurse kishte paralajmëruar në media, Klement Balili u vetëdorëzua mëngjesin e të martës pas tre muaj negociatash me policinë, e cila dështoi në 15 aksione për kapjen e tij. Në një intervistë për gazetarin investigativ, Artan Hoxha, ai tregoi arsyet se përse nuk ishte dorëzuar për më shumë se dy vite. "Nuk jam dorëzuar për arsyet se nuk kisha provat e duhura këtu në Shqipëri, përse më akuzonin dhe çështja në momentin e parë u politizua në të dyja ekstremet. U bënë shumë akuzat të rënda ndaj meje, u quajta 'Eskobar'. Dhe normalisht që unë nuk kisha besim", u shpreh Balili. Gjithashtu, ai deklaroi se kishte qëndruar i fshehur rrotull, në vendet me publik të madh si Gjirokastra dhe në qytete të tjera të mëdha dhe se policia asnjëherë nuk ishte afuar.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – the "RFP ASSESSMENT OF CURRENT MUNICIPAL PERFORMANCE MEASUREMENT SYSTEMS AND IDENTIFICATION OF POTENTIAL COMPLEMENTARITIES" for STAR 2 Project

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 52734**

RFP for "RFP ASSESSMENT OF CURRENT MUNICIPAL PERFORMANCE MEASUREMENT SYSTEMS AND IDENTIFICATION OF POTENTIAL COMPLEMENTARITIES" for STAR 2 Project

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 08-Feb-19

Address for communications:
 Email: procurement.al@undp.org
 Or
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
 Tirana, Albania

QEVERIA BETIMI

Ministrit e larguar u kanë dorëzuar dje detyrën ministrave të rinj, emocionohet Braçe

Rama bojkoton ceremoninë e betimit, ministrit e rinj marrin detyrën

Në Presidencë, qeverinë e përfaqësoi Engjell Agaçi

Një ditë pas votimit në Kuvend, 7 ministrit e rinj dhe zëvendëskryeministri kanë marrë dje zyrtarisht detyrën. Ndryshe nga sa ndodhi me fazën e shqyrtimit të emërimeve para se të nxirrte dekretet, Presidenti i Republikës, Ilir Meta nuk ka vonuar të organizojë ceremoninë e betimit, duke i hapur rrugë kështu marrjes së detyrës nga ana e ministrave të rinj.

BETIMI

Dje rreth mesditës, ai ka pritur në Presidencë 8 prurjet e reja në qeveri në një ceremoni solemne, ku binte në sy mungesa e kryeministrit Edi Rama. Ndonëse bëhej fjalë për ndryshimin e më shumë se gjysmës së qeverisë së tij, kryeministri nuk ishte i pranishëm në momentin e betimit të ministrave të rinj. Nga qeveria, i pranishëm ishte vetëm sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Engjell Agaçi, ndërsa nga Kuvendi, nënkryetarja Vasilika Hysi. Fillimisht Presidenti Meta ka përshëndetur personalisht secilin prej ministrave të rinj dhe më pas i ka ftuar ata që të betohen me dorën mbi Kushtetutë. I pari ka qenë zëvendëskryeministri, Erjon Braçe dhe më pas gjithë ministrit e rinj, të cilëve iu dorëzua edhe dekreti i emërimit në këtë detyrë të re.

MARRJA E DETYRËS

Fill pas betimit, qeveria ka organizuar edhe procesin e kalimit të stafetës nga ministrit e larguar te ministrit e rinj. E pari që ka organizuar ceremoninë kalimit të detyrës ka qenë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku Damian Gjiku-nuri i ka kaluar detyrën ministres së re Belinda Balluku. Gjiku-nuri në fjalën e tij nuk i kurseu batutat, ndërsa u shpreh se i gjithë fjali-mi i mbajtur ishte me 'fjalë zemre'. "Unë do e thërras shkurt Bela, gjej rastin t'i uroj suksese në këtë punë të vështirë, sfiduese, por edhe interesante, falënderoj stafin. Kaluam me rezultate, por edhe dështime, se edhe ato janë pjesë e jetës. Bela



Ministrit e rinj dje në Presidencë

ANËTARËT E RINJ TË KABINETIT

- 1-Erion Braçe, zëvendëskryeministër
- 2-Besa Shahini, ministre e Arsimit
- 3-Anila Denaj, ministria e Financave
- 4-Belinda Balluku, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
- 5-Elva Margariti, ministre e Kulturës
- 6-Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
- 7-Eduard Shalsi, ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- 8-Blendi Çuçi, ministër i Bujqësisë

njihet me një pjesë prej jush, sfidat sjellin sfida të reja. Jam i bindur se Bela i ka mundësitë, kapacitetin dhe vullnetin që këto nisima t'i çojë përpara. I kam thënë mua do më kesh këshilltar për çdo gjë, kyçi i punës këtu është të inkurajosh stafin, të

bashkëpunosh me stafin", - tha Gjiku-nuri. Ndërsa ministria e re, Belinda Balluku theksoi se do e çojë punën dhe reformat edhe më tej. "Sigurish unë vij nga brenda kësaj ministrie, kam drejtuar një sektor të rëndësishëm si navigimi ajror.

MUNGESA

Ndonëse bëhej fjalë për ndryshimin e më shumë se gjysmës së qeverisë së tij, kryeministri nuk ishte i pranishëm në momentin e betimit të ministrave të rinj. Nga qeveria i pranishëm ishte vetëm sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Engjell Agaçi, ndërsa nga Kuvendi, nënkryetarja Vasilika Hysi.

Vlerësoj punën që keni bërë, Damiani dhe jam këtu për të vazhduar atë që ka nisur. Absolutisht besoj se gjëja më e mirë për t'u bërë është mbyllja e punëve të nisura si kantierëve që janë hapura", - tha Balluku. Më pas ishte radha e Senida Mesit që t'i kalonte detyrën Erion Braçes, nëpërmjet një ceremonie të organizuar në ambientet e godinës së Këshillit të Ministrave. Braçe nuk i përmbajti dot emocionet, ndërsa u shpreh se e kishte të vështirë të fliste si anëtar i qeverisë, duke qenë se gjithmonë ka qenë pjesë e legjislativit. "E kam të vështirë të flas nga kjo anë e bulevardit", - tha Braçe. Një ceremoni e ngjashme u zhvillua më pas edhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku Arben Ahmetaj i dorëzoi detyrën ministres së re, Anila Denaj.

Soreca përshëndet ministrit e rinj: Mirëpres të punoj me të gjithë

Ambasadori i BE në Shqipëri, Luigi Soreca ka uruar ministrit e rinj të kabinetit qeveritar, pas betimit të tyre në Presidencë. Përmes një postimi në "Twitter", ambasadori i BE-së shprehet se ministrit e rinj marrin detyrën në një moment të rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë. "Urime anëtarëve të rinj të kabinetit që u betuan sot para Presidentit Meta. Ata



marrin detyrën në një moment të rëndësishëm për të ardhmen evropiane të Shqipërisë në rrugën drejt BE-së. Mirëpres të punoj me të gjithë!", - shkruan ambasadori i BE në Tiranë, Luigi Soreca. Në fakt, Soreca është i vetmi diplomat në Tiranë që ka përshëndetur publikisht ndryshimet në qeveri të iniciuara nga kryeministri, Edi Rama që në fund të muajit dhjetor.



Presidenti Ilir Meta, mbrëmë në emisionin "Të Paeksponuarit" në "News 24"

SHKURTE

Kryeministria ndryshon fotot e ministrave në faqen në internet

Mënjëherë sapo ministrit e rinj kanë marrë detyrën, Këshilli i Ministrave nxitoi të ndryshojë dhe përbërjen e qeverisë në faqen zyrtare në internet. Kryeministria me zyrtarizimin e tyre ka përditësuar fotot e kabinetit, ku bien në sy të gjitha prurjet e reja në kabinet. Rama tashmë ka në krah Erion Braçen si zëvendëskryeministër dhe 7 ministrit e rinj, që janë propozuar prej tij në ditët e fundit të vitit të kaluar. Ajo që bie në sy është se emri i Ditmir Bushatit nuk është hequr, pasi Presidenti ende nuk ka dekretuar shkarkimin e tij. Kreu i shtetit nuk ka vendosur ende në lidhje me dekretin e shkarkimit të Ditmir Bushatit si dhe të dekretit tjetër të emërimit në vend të tij të kryeministrit Edi Rama. Ai ka deklaruar se do ta ushtrojë këtë kompetencë brenda afateve kushtetuese, afat që përfundon të hënën.

Balla: Mbështetje të plotë për anëtarët e rinj të qeverisë

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka shprehur mbështetjen për ministrit e rinj, të cilët kanë marrë detyrën pas betimit dje në Presidencë. Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, Balla ka deklaruar se anëtarët e rinj të qeverisë marrin përgjegjësi të rëndësishme në këtë moment kyç, siç është hapjen e negociatave me BE. "Shumë besim dhe mbështetje të plotë për anëtarët e rinj të qeverisë, të cilët marrin përgjegjësi të rëndësishme në këtë moment kyç të rrugës sonë evropiane. Në qershor Shqipëria pret hapjen e negociatave me BE. Me vëmendjen për njerëzit, PS është e vetmja forcë politike në Shqipëri me lidhshmëri, ekipin dhe programin për ta realizuar këtë aspiratë historike", - shkruan Balla. Dy ditë më parë ai sulmoi Presidentin e Republikës, në lidhje me mosdekretimin e Genti Kajakaj, ndërsa e konsideroi atë si kryetar alternativ i opozitës.

Luan Rama uron Erion Braçen: Ta njih devocionin

Deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Luan Rama ka uruar dje Erion Braçen për marrjen e detyrës së re si zëvendëskryeministër. Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, Luan Rama, megjithëse në opozitë, nuk ka nguruar të shpreh urimin për një nga miqtë e tij të vjetër në radhët e socialistëve. "Një urim për Erion Braçen! Erion, suksese në detyrën e zëvendëskryeministrit, mbarësi dhe fagebardhë në përbushje të përgjegjësisë së re! Kemi punuar bashkë në kohë të vështira, atëherë kur "Zëri i Popullit" ishte Partia Socialiste e më shumë se aq dhe kur për ne u bë shtëpi dhe shkollë. T'a njoh devocionin dhe 27 vjetet përkushtim e shërbim si socialist, jam i bindur, do të të ndihmojnë të bësh më të mirën", - shprehet Luan Rama.



Balili, i lidhur me LSI? Presidenti: S'e kam takuar asnjëherë, kërkova arrestimin e tij

A do ta dekretojë Ramën ministër: Brenda 24 orëve, vendimi më i drejtë

"Emërimi i Cakajt, s'mund të bëj eksperimente"

Ylli Rakipi

Presidenti Ilir Meta, i ftuar mbrëmë në emisionin "Të Paekspozuarit" në "News 24", iu përgjigj akuzave të kryeministrit Rama se është shkelur Kushtetuta me kthimin e disa ligjeve si dhe me mosdekretonimin e Genc Cakajt si ministër. Me Kushtetutën në dorë, z.Meta garantoj qytetarët se sipas tij, Presidenti i Republikës merr vendimet e tij vetëm në përputhje me ligjet e vendit.

Z. President, cila është përgjigja juaj për një sërë akuzash të kryeministrit Rama për kthimin e disa ligjeve si dhe mosdekretonimin e Cakajt si ministër?

Unë kam ardhur me Kushtetutë, nëse doni detaje. Të gjithë qytetarët që na ndjekin duhet të jenë të qetë sa i takon presidentit të tyre, pasi çdo akt dhe veprim i tij ka qenë në interes të respektimit të Kushtetutës dhe në mbrojtje të interesave shtetërore. Aty u tha që Ilir Meta kthen ligjin për dividentin dhe kam shkelur Kushtetutën. Neni 155 thotë tek "Financat se taksat dhe tatumet përcaktohen me ligj. Kushtetuta thotë se ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese. Bëhet fjala për një dëm të madh, jo vetëm për shkelje të Kushtetutës, por dëm të madh të financave publike. Unë mund të bëj edhe politikë dhe të them se këto fonde do t'i përfitojë një grup, që ka pasur dijeni se do të bëhej një ligj i tillë. Çdo qëndrim i presidentit ka qenë vetëm në interes të ligjit. Nuk shqetësohem për sulmet, është e drejta e tij. Çdo qëndrim i presidentit është në respekt të Kushtetutës. Kuvendi është sovran dhe mori vendimin e tij, por presidenti zbaton Kushtetutën. Është e qartë se kush e shkel Kushtetutën.

Refuzimi i Gent Cakajt. Jeni ndjerë i kërcënuar në këtë rast, pasi keni thënë që keni marrë kërcënime?

Nuk është problemi se unë ndihem i kërcënuar, por



Presidenti Ilir Meta

tjetër. Kjo do të thotë se ju nuk do ta dekretoni Ramën?

Presidenti ka të drejtë të bëjë interpretimin e tij fillestar.

Nëse Edi Rama do ju sjellë 5 ministra që do jem unë në këto ministri, ju çfarë do të bëni, do ta dekretoni?

Që të jemi të qartë, kjo nuk thuhet në Kushtetutë, as e përjashton dhe as e aprovon këtë gjë. Ne shikojmë parime dhe precedentet tanë dhe të vendeve të tjera që mund të kenë qenë.

Ju po bëheni normalë dhe po thjeni Kushtetutën...

Unë nuk thash as do e dekretojë dhe as e çdekretoj. Unë pas këtij emisioni do takoj këshilltarët e mi dhe ndoshta nesër mund të marrim vendimin. Ne do të marrim vendimin më të drejtë.

Qarkullojnë fjalët se Balili ka qenë i lidhur fillimisht me PD, LSI dhe së fundmi me Rilindjen... Ju si parti, që keni qenë dje, jeni akuzuar se keni pasur lidhje me Balilin, si është e vërteta?

E para, ajo që dua t'iu them është se e përhëndës faktin që më në fund, Balili, një person i akuzuar për trafikje mjaft serioze do përballë me drejtësinë. E dyta, pavarësisht nga dobia e agjencive tona për të realizuar një aksion të drejtëpërdrejtë është ky presion i gjithanshëm, përfshirë dhe partnerët tanë ndërkompartë, që e detyron këtë person të përballë me ligjin. Në kohën që kam drejtuar LSI-në, Rigers Balili (nipi i Klemend Balilit) që është

KRYEMADHI: ME KERCENJAN
"Vajzën e vogël jam detyruar që ta çoj në një koleg me konvikt, sepse jam kërcënuar unë mamaja e saj. Nuk kam ndërmend t'i them këtu, por do ta zgjidh sipas mënyrës sime", tha Monika Kryemadhi dhe e përlotur në emisionin "Open" në "Top Channel".

kryetar i Delvinës është një person i verifikuar nga të gjithë, siç janë verifikuar të gjithë kryetarët e bashkive, proces vetingu ky ku u përfshinë dhe ambasadat, ishte një sëmshim tërësisht i besueshëm dhe me të dhënat e duhura për të kandiduar. Unë s'e kuptoj se çfarë lidhje mund të thuej apo çfarë mbështetje ka pasur ky veçanërisht kur është akuzuar. Për sa i takon raportit, s'mund të them që nuk i kam dhënë dorën në rastin e përvendimit të "Santa Quaranta"-s, por s'kam pasur asnjë takim të veçantë. Asnjëherë s'më është thënë nga policia apo SHISH, "shiko që mos kontakto me këtë person se ka këtë apo ato probleme". Kur është akuzuar, kam kërkuar mbledhje të Sigurisë Kombëtare dhe kërkuar arrestimin e tij. Pak kohë më parë, për këtë çështje, u kam thënë edhe partnerëve tanë më të rëndësishëm. Unë si president u kam thënë se nëse s'besoni se policia, agjencitë tona, s'kanë vullnetin për ta arrestuar këtë person, sillni forca speciale, logjistike për të arrestuar këtë apo çdo person që duhet të përgjigjet para drejtësisë.

A keni ambicie për të marrë frenat e opozitës?

Unë nuk e shoh aspak këtu, kjo zgjedhje u bë në një rast krize dhe kjo krizë kaloi. Deri në 24 korrik të vitit 2022, jam i motivuar që të vijoj këtë detyrë dhe nuk e ndërroj me asnjë detyrë as në Shqipëri dhe as në botë, por do të vijoj të luftoj për këtë Kushtetutë. Nuk kam ambicie as për këto zgjedhje dhe as të zgjedhjeve të 2021, nuk kam farë lidhje.

"UNAZA E RE"

Presidenti Meta komentoi dje projektin e Unazës së Re si dhe anulimin e lotit të parë, pasi u zbulua se kompania fituese kishte falsifikuar dokumentet. Ai tha se projekti i Unazës është totalisht jotransparent dhe shpreson që të ketë transparencë me ardhjen e ministres së re.

Hahn, Ramës: S'ka të ardhme në BE, pa dialog me opozitën

Komisioneri i BE-së për Politikën Evropiane të Fqin jesisë dhe Negociatit e Zgjerimit, Johannes Hahn u takua dje në Tiranë me kryeministrin Edi Rama, me të cili diskutoi ecurinë e reformave që lidhen me integrimin në BE dhe zhvillimet e fundit politike në rajon. Komisioneri paralajmëroi kryeministrin se nuk do të ketë integrim të vendit në BE, nëse nuk do të ketë dialog me të gjitha partitë politike në vend. "Angazhimi i fortë në procesin e integritimit në BE nga kryeministri Rama është kyç dhe dialogu konstruktiv politik midis të gjitha partive politike, si dhe gatishmëria për të punuar së bashku në interes të të gjithë qytetarëve shqiptarë është thelbësore për të ardhmen evropiane të Shqipërisë", - citohet z.Hahn në deklaratën për shtyp që publikoi zyra për shtyp e Delegacionit të BE në Tiranë. Z.Hahn po ashtu kërkoi që të ketë një pakt politik mes partive: "Një marrëveshje ndërpartiake për reformën zgjedhore për të trajtuar rekomandimet nga OSBE/ODIHR do të ishte një mundësi e mirë për ta treguar një gatishmëri të tillë", - deklaroi z.Hahn. Ai i kujtoi z.Rama se 2019-ta është një vit vendimtar për Shqipërinë. "2019-ta është një vit vendimtar për Shqipërinë. Kam besim se qeveria, institucionet dhe të gjitha forcat politike do të vazhdojnë me ritme të rëndësishme në reformat kyçe, përpara vendimit të Këshillit të Europës në qershor, duke realizuar perspektivën e saj evropiane", tha Komisioneri Hahn. Rama dhe Hahn patën mbrëmë një darkë pune, ku në fokus të bisedës së tyre mendohet të ketë qenë reforma zgjedhore, reforma në drejtësi, por edhe kushtet e tjera të vendosura nga BE për integrimin.

Njoftim për shitje me ankand te dyte

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nonin 568, 577, e vijues te K.P.T.C shpall ankandin e dytë për pasurinë e palles debitorum Sh "Strati Construcion" sh.p.k. - Pasuria perbehet nga :
 -"Ate" Nr. pasurije 112/23 ndodhur ne Draz dhe Durres, Z.K.Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m², Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 2.240.000 lekë
 -"Apartment" , Nr pasurije 116/61-1-19 ne Kryemadhen Kavaje , Z.K.Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 33.19 m², Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 1.064.000 lekë
 -"Apartment" , Nr pasurije 116/61-1-20 ne Kryemadhen Kavaje , Z.K.Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59.24 m² dhe Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 1.904.000 lekë
 Ankandi qendron hapur 30 dite dhe do te zhvillohet ne date 14.02.2019 ne orën 15:00 ne Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kall 2, Zyra nr. 5 Tiranë Kontakt tel. 00355 67 20 843 e-mailit ilir.dervisha@yahoo.com e WEB www.powerjustice-al.com

Njoftim për shitje me ankand te II

Shqiptëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do te zhvilloje ankandin e dyte te pasurisë te palles debitorum Shqiptëria "G.I.P.R.A" sh.p.k. e perbehet nga :
 -"ARE" Nr pasurije 31/33, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m², ne Kofthas, Durres Ankandi i II fillon me çmim fillestar ne masen 114.532 Euro
 -"ARE" Nr. n pasurije 31/4, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m², ne Kofthas, Durres, Ankandi i II fillon me çmim fillestar ne masen 210.073, 92 Euro
 -"ARE" Nr pasurije 31/5, Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m², ne Kofthas, Durres Ankandi i II fillon me çmim fillestar ne masen 70.024, 64 Euro.
 Ankandi do te zhvillohet ne date 14.02.2019 ora 15:00 ne sallsi, Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kall 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir.dervisha@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA nr. 1/358, e lotit "Trrali dhe Ndrertes" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur ne ish-Fushën e Aviacionit, TIRANE) me sipërfaqe të truallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtime prej 200,2 m², Zona Kadastrele 8220, Vol. 23, Fq. 28, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

ÇMIMI 25.472.989,70 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.02.2019.

CEL: 0684026666; 0693262866.

OPOZITA PROTESTA

Kreu i PD-së me ministrin holandez: Qeveria po i rrezikon Shqipërisë negociatat

Basha: Protesta popullore, deri në rrëzimin e qeverisë

"Do parashtrojmë një zgjidhje politike"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, ftoi dje mbarë shqiptarët që të ngrihen kundër regjimit të Edi Ramës. Sipas tij, qytetarët do t'i japin goditjen përfundimtare qeverisë. Por aksioni i opozitës për rrëzimin e qeverisë 'Rama' do të alternojë protestat me debatimin parlamentar. Stina e protestave nuk do të kufizohet të betejë kundër qeverisë, por edhe të përvijimi i alternativës së opozitës. "Rrugë e vetme për t'u përballur është rruga e angazhimit të gjithë, bashkimit të qytetarëve për t'i dhënë fund kësaj fasade. Ka marrë një goditje fatale nga lëvizja studentore, duhet të marrë një goditje përfundimtare nga qytetarët e bashkuar. Për këtë arsye opozita vendosi të udhëhojë protestat qytetare deri në largimin e kësaj qeverie. Si kundër po bëhet gati për të parashtruar një zgjidhje politike për të cilën do të kemi një vendimarrje konkrete në Këshillin Kombëtar të PD ditën e shtunë dhe do të kemi një mobilizim të opozitës në bashkëpunim me qytetarët", theksoi z.Basha. Ai përmendi se protestat janë një mundësi për të folur me njerëzit dhe për të ndarë me ta vizionin për të nesërmen. Basha shpjegoi nevojën e këtij reagimi me situatën e vështirë që po kalon vendi, me një kryeministër të zhytur në korrupsion që ka kapur të gjitha institucionet. "Ka ardhur koha që këto të vërteta të mos fshihen apo të sheqerosen, sepse përndryshe 'asgjë të re nuk do të kemi nga fronti i perëndimit'. Unë dhe Partia Demokratike jemi të vendosur ta ndalim këtë, ta ndalim krizën politike, ta ndalim krizën ekonomike, ta ndalim krizën e thellë të besimit dhe shpresës tek vendi ynë", theksoi z.Basha. Ndonëse opozita e bashkuar nuk ka vendosur ende një datë për nisjen e protestave, Lulzim Basha përsëriti pas një takimi që zhvilloi dje me ministrin e Jashtëm të Holandës, Stef Blok se aksioni për largimin e kryeministrit Rama dhe rrëzimin e



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

qeverisë nuk do të ndalet deri në finalizimin e qëllimit. "Shqiptarët nuk kërkojnë vetëm largimin e vetëm një njeriu, por largimin e një modeli dhe zëvendësimi i tij me një model që të punojë për ta, modeli evropian. Sezoni i protestave që do nisë, do të jetë një mundësi për të folur me njerëzit, për të ndarë me ta vizionin dhe platformën tonë për të nesërmen", theksoi z.Basha. Të drejtë e cilësoi edhe skepticismin e Holandës në lidhje me vendimin e qershorit për hapjen e negociatave, duke

bërë përgjegjëse qeverinë për mospërbushjen e kriterëve të vendosura nga unioni. "Shqipëria po zhytet në një krizë të thellë politike. Situata e përgjithshme përshkruhet me dy fjalë: kryeministri ka kapur të gjitha pushtetet. Këto të vërteta nuk duhet të fshihen, pasi dyert e Europës do të vijnë të mbyllura, negociatat do të vijojnë të hapen për vende të tjera dhe jo për Shqipërinë", u shpreh kreu i PD-së. Por, një ndër kriteret që Shqipëria do të duhet të përmbushë për çeljen e

KRIZA

"Ka ardhur koha që këto të vërteta të mos fshihen apo të sheqerosen, sepse përndryshe 'asgjë të re nuk do të kemi nga fronti i perëndimit'. Unë dhe PD jemi të vendosur ta ndalim krizën politike, ta ndalim krizën ekonomike, ta ndalim krizën e thellë të besimit dhe shpresës tek vendi ynë", tha z.Basha.

dritës jeshile në muajin qershor është edhe reforma zgjedhore, për të cilën ndërkombëtarët ditët e fundit kanë rritur presionin ndaj klasës politike, ku u kërkojnë palëve të votojnë sa më parë ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Pak ditë më parë dy ambasadorët; ai i BE-së dhe OSBE-së pas takimeve që zhvilluan me kreun e opozitës dhe përfaqësues të mazhorancës, u shprehën se ndonëse vetëm 5 muaj larg zgjedhjeve, ka ende kohë për të miratuar reformat ektorale.



Një nga protestat e opozitës

TAKIMI

Kreu i PD-së pas takimit me ministrin e Jashtëm holandez deklaroi se qeveria ka rënë dhe shumë shpejt do të nisim protestat. Ai tha se në takimin që pati me kreun e diplomacisë holandeze, e gjithë vëmendja ishte e fokusuar te zhvillimet në vend.



"Unaza", banorët: Rama e mbushi kupën, do e tërheqim zvarrë

Në ditën e 75-të protestës, banorët e "Asirit" bllokuan rrugën kryesore, ndërsa me thirrje dhe pankarta në duar kërkojnë anulim të projektit që shemb banesat e tyre. "Ne jemi shembulli i gjithë Shqipërisë se kemi 75 ditë që luftojmë për shtëpitë tona. Jo nga Kamza, por edhe nga Saranda do vijmë këtu ta tërheqim zvarrë Edi Ramën se e ka mbushu kupën. Do të na fusë në konflikt për një arsye vërtetë madhore që të mbushë xhepat Edi Rama. Këtu po protestojmë, këtu është puna jonë. Në Unazën e Re vendosim ne, vendos sovranin. Por ti nuk di të mbash fjalën se je femër", u shpreh një nga banorët. Të pranishëm në protestë në mbështetje të banorëve ishin edhe deputetët e opozitës. Deputeti demokrat, Klevis Balliu nga protesta nuk kurseu akuzat ndaj kreut të qeverisë, Edi Ramës, ndërsa paralajmëroi edhe revolta masive. "Të dashur qytetarë, siç kishim lajmëruar këtu do japin llogari. Seancën e fundit parlamentare nuk donim diskutime se e dimin që do flisim për aferën korruptive të Unazës së Re. Ku më mirë sesa këtu në këtë shesh që ne e kemi bërë shesh heroik. Pa anulimin e projektit nuk do të ketë asnjë hap nga kjo qeveri. Ndërkohë që ky zotëria kërkon negociatat me studentët, bën sikur bën pseunegociatat me disa banorë të 'Astirit', por me sovranin nuk ka negociatat. Ku nuk ka parlament dhe institucione, nuk mbetet gjë tjetër veçse revolta", tha deputeti i PD-së.

Protestat, rruga e vetme kundër qeverisë

Mustafaj: Denoncimet dhe skandalet bien në vesh të shurdhër të Ramës

Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj beson se protestat janë rruga e vetme kundër qeverisë "Rama". I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24", Besnik Mustafaj tha se rruga e vetme për të rrëzuar qeverinë është përmes protestave, pasi sipas tij, kjo qeveri nuk dëgjon dhe denoncimet dhe skandalet bien në vesh të shurdhër: "Opozita ka arritur në përfundimin se fjala e ka humbur peshën dhe qeveria nuk dëgjon. Rrugë e vetme ndaj qeverisë është protesta në rrugë. Opozita mat forcat e veta, sepse nuk ka rrugë tjetër. Denoncimet dhe skandalet e publikuara bien në vesh të shurdhër të kryeministrit. Fakti është se e kemi pasur një periudhë ku pakënaqësia është shprehur përmes protestave, siç janë



studentët apo banorët e 'Astirit'. Opozita në një situatë të tillë ka për detyrë morale dhe kushtetuese që të strukturojë këtë pakënaqësi dhe t'i japë në lloj programi. Nëse opozita është e aftë apo jo për të t'i dhënë asaj një perspektivë, kjo mbetet të shihet. Dje u parandalua një seancë denoncimesh ndaj qeverisë. Ne kemi bërë referoma në këto 30 vite, reforma që prekin aspekte të ndryshme të sistemit dhe nuk kemi bërë punë për të ndryshuar mentalitetin e njerëzve për të vënë në lëvizje këtë sistem", - tha Mustafaj.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e TRETË, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke NGB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji i pasurisë: Ares - Trull (magazinë dy kate) me sip. arë 3000 m2 / trull 1661/ndërtës 234.9, me nr.pasurie 58/9 vol 8 fq.76, z.k.1475, Derven, KRUIË në pronësi të: Haki Ahmet MAVRIQI Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 60.480 (gjashtëdhjetë mijë e katërdjehetë tetëdhjetë) EUR

Ankandi zhvillohet në datën 15.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartuesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Pasuritë



Shqipëria ka rreth 4.4 milionë prona, nga të cilat rreth 3.8 milionë janë regjistruar dhe janë rreth 600 mijë pasuri të tjera të paregjistruara ende. Ndërkohë që rreth 2.5 milionë e pasurive të regjistruara janë me probleme.

Pronat



Nga 47 mijë praktika që ka pasur në të gjithë kohët AKKP-ja, janë marrë deri tani 26 mijë vendime dhe 18 mijë janë rivlerësuar me ligjin e ri. Ndërkohë që janë rreth 8 mijë praktika ende të patrajtuara që nga '93.

Tokat



Rreth 50 për qind e pronave të kësaj kategorie janë të paregjistruara. 438 mijë familje fshatare kanë përfutur me ligjin e ndarjes së tokës, nga të cilat rezultojnë rreth gjysma ende të paregjistruara në ZRPP, në kadastrë.

TE DHENAT

Kreu i ALUIZNI-t tha se institucioni i parë që do regjistrohet do jetë Presidenca

Lame: 2.8 milionë prona në të gjithë Shqipërinë duhet të maten sërish

Ligji krijon praktikën për zgjidhjen e problemeve në terren

Më shumë se 2.8 milionë prona në të gjithë Shqipërinë kanë probleme me sipërfaqet dhe kufijtë, ndaj dhe duhet të maten sërish. Këtë fakt e pohoi dje drejtori i Agjencisë së Legalizimeve, Artan Lame, teksa i ktheu përgjigje Presidentit të Republikës lidhur me kthimin për rishqyrtim të ligjit "Për Kadastrën". Sipas Lames, afro 80 për qind e pronave që zotërojnë sot shqiptarët, në formë e tokës bujqësore, truall apo të ndërtimeve të ndryshme, kanë probleme të natyrave të ndryshme dhe që më e pakta që duhet të bëhet për të është të rimaten për të dhënë përkufizimet e sakta të gjendjes reale në terren. "Sipas raportit të BB, shteti duhet të rimatë 80% të pronave të matura në këto 25 vjet. 2.800.000 prona që presin të rimaten nga themelet se janë lëmsh", - deklaroi Lame gjatë komunikimit publik me mediat. Pra, nga rreth 4.4 milionë pasuri që ka në gjithë vendin, më shumë se gjysma e tyre kanë probleme. Ndonëse Lame nuk dha detaje të problematikave më të shpeshta, mësohet se të gjitha ato kanë të paktën nga një veprim për të kryer në institucionet shtetërore ose në rastin më të keq për t'u matur dhe për t'u regjistruar nga e para. Çka do të thotë që minimalisht duhen azhurnuar dhe përmirësuar, pasi janë pasuri të deformuara, duke qenë një nga shkaqet kryesore të sorollatjes së qytetarëve nëpër sportele dhe nëpër gjyqe. Duke argumentuar nevojën e miratimit të ligjit "Për Kadastrën", Lame bëri të ditur se ai trajton dhe tenton t'i japë zgjidhje edhe të gjitha këtyre prona me probleme. Gjithashtu, ai theksoi se falë ndryshimeve që sjell ky ligj, bëhet e mundur edhe trajtimi i afro 66 mijë dosjeve me praktika të legalizimeve, që ligji aktual nuk ka mundur t'i japë zgjidhje, si dhe do mundësojë edhe regjistrimin e të gjitha pronave shtetërore që skanë sot certifikata pronësie. "Mirë 74 deputetëve që do ta rivotojnë ligjin e Kadastrës



Drejtori i Agjencisë së Legalizimeve, Artan Lame

PRESIDENCA

"Garantoj zotim president se, një ditë pas fillimit nga puna të Agjencisë së re Kadastrës, punonjësit e saj do të paraqiten gjithë respekt në derën e Presidencës së Republikës në Tiranë dhe në Portën e Mauzoleut të Skënderbeut në Lezhë, për të filluar procedurat e lëshimit të certifikatave të pronësisë për to".

Rama: I pakuptimtë kthimi i ligjit nga Presidenti Meta

Sikur të mos mjaftonte debati për ministrin e Jash Stëm, konfliktit mes Presidentit Ilir Meta dhe kryeministrit Edi Rama i është shtuar edhe çështja e kthimit të disa ligjeve të rëndësishme dhe të miratuara pa praninë e opozitës. Pak ditë më parë, në kulmin e debatit për ndryshimet në qeveri, kreu i shtetit i ktheu qeverisë ligjin "Për Notarinë" dhe ligjin "Për Kadastrën", të cilët sipas tij vinin në kundërshtim me Kushtetutën dhe një sërë normash të tjera ligjore. Por sipas kryeministrit Rama, të paktën kthimi i ligjit "Për Kadastrën" është krejt i pakuptimtë. Ai ka pasqyruar dje në faqen e tij në rrjetin social "Facebook", konferencën për shtyp të kreu të ALUIZNI-t, Artan Lame ku ky i fundit i ktheu përgjigje presidentit Meta për argumentet që ai ka paraqitur në relacionin që shoqëron dekretin për kthimin e ligjit. "Drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t dhe kryetari i Komisionit të Reformës së Agjencive të lidhura me pronën, informon publikun për kthimin e pakuptimtë të Ligjit të Kadastrës nga Presidenti Ilir Meta", - shkroi Rama.



ARGUMENTET ME TË CILAT KREU I SHTETIT KTHEU LIGJIN "PËR KADASTRËN"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ktheu pak ditë më parë për rishqyrtim në Kuvendin ligjin "Për Kadastrën". Në relacionin shoqëruar të këtij dekreti, Meta paraqiste 5 argumente, të cilat sipas tij e bëjnë këtë ligj antikushtetues. Ja argumentet që ka paraqitur presidenti:

- 1 - Nenet 6 pika 1, 13 pika 6, 22 pika 2, të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", bien ndesh me legjislacionin bazë të së drejtës civile në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se Agjencia Shtetërore e Kadastrës është administratore e regjistrimit kombëtar kadastral dhe ky institucion ndodhet në varësi të kryeministrit, atëherë në mënyrë automatike kryeministri nëpërmjet institucionit të tij të varësisë, ASHK, merr atributet e administratit të regjistrimit shtetëror të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. E gjithë varësia administrative hierarkike kalon nën përgjegjësinë e kryeministrit dhe në këtë mënyrë dispozitat e nenit 6 pika 1, nenit 13 pika 6, nenit 22 pika 2, të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" bien ndesh në mënyrë flagrante me parashikimet e nenit 198 të Kodit Civil.
- 2- Ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën", me mangësitë që paraqet cenon parimin e sigurisë juridike në qarkullimin civil të pasurive të paluajtshme si dhe standardin kushtetues të të drejtave të fituara. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ligjit nr.111/2018

"Për Kadastrën", konstatohet se ky ligj nuk ofron mjetet e plota ligjore në mënyrë që individit të krijohet sigurinë që informacioni që do të marrë nga regjistri i pasurive të paluajtshme është i garantuar dhe në rast të dëmit që mund ti vijë nga dhënia apo një veprimi të gabuar të AKSH ekziston zgjidhja ligjore në këtë drejtim.

3 - Neni 37/b i ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", cenon parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës dhe bie ndesh me jurisprudencën kushtetuese. Referuar përmbajtjes së dispozitës, kuptohet se një titull pronësie i dhënë nga Ish-Komisionet e Kthimit dhe Komensimit të Pronave ndër vite, Kontratat e Privatizimit të Pronës Publike, Lejeve të Legalizimit, Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, apo çdo akti tjetër administrativ që ka krijuar një titull pronësie, tashmë mund të korrigjohet nga ASHK.

4 - Parashikimet jo të plota të pikës 2 të nenit 28, të ligjit nr. 111/2018, krijojnë rrezik për cenimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale që administrohen në regjistrim publik dixhital të pasurive të paluajtshme.

5 - Parashikimet e ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" që referojnë në një tjetër ligj, i cili aktualisht është në statusin e projektligjit dhe ende i pamiruar nga Kuvendi cenonjë haptazi parimin kushtetues të shtetit të së drejtës.

po ju themi të presin, po si tua shpjegojmë hallin e presidentit 60.000 familjeve që presin të mbyllin legalizimet, 220.000 fermerëve që presin të regjistrojnë tokën,

50.000 familjeve që presin të ligjërojnë banesat e vjetra, apo 2.800.000 pronave që presin të rimaten nga themelet se janë lëmsh?! Nëse për shumë ligje të tjera që presi-

denti ka kthyer, vonesa penalizon grupe të veçanta njerëzish, kthimi i Ligjit të Kadastrës penalizon çdo shqiptar që ka një cerek shekulli që gjen belanë me

pronën", - theksoi Lame. Madje, Lame bëri të ditur se në kuadrin e problematikave që trajton ky ligj, do mundësojë edhe regjistrimin e institucioneve më të rëndësishme shtetërore në vend, si Presidenca, Kuvendi i Shqipërisë apo edhe Kryeministria. Sipas tij, ligji i ri do krijojë një mekanizëm të ri të funksionimit për zgjedhjen e problematikave, ku ashtu si në shumëbulin e ALUIZNI-t, do jenë specialistët e Kadastrës, ata që do shkojnë në terren për t'i dhënë zgjidhje problemit që mund të ekzistojë me një pronë. Në këtë kuadër, ai duke ironizuar presidentin për kthimin e ligjit, bëri të ditur se sapo të ngrihet Kadastra, Presidenca do jetë institucioni i parë ku ata do shkojnë për të bërë regjistrimin e saj si pronë

shtetërore. "Garantoj zotim president se, një ditë pas fillimit nga puna të Agjencisë së re së Kadastrës, punonjësit e saj do të paraqiten gjithë respekt në derën e Presidencës së Republikës në Tiranë dhe në Portën e Mauzoleut të Skënderbeut në Lezhë, për të filluar procedurat e lëshimit të certifikatave të pronësisë për to, ashtu siç do vijojnë më tej me zgjidhjen e problemeve të certifikimit të pronës për gjithë prona të tjera të shqiptarëve të këtij vendi", - tha Lame. Shqipëria rezultoi me rreth 4.4 milionë pasuri të paluajtshme, nga të cilat rreth 3.8 milionë janë regjistruar dhe janë rreth 600 mijë pasuri të tjera të paregjistruara ende. Ndërkohë që rreth 2.8 milionë pasuri nga ato që janë regjistruar kanë probleme.

Ngjarja në gusht të 2017-ës, 54-vjeçari: Jam penduar

Vrau ish-bashkëshorten gjyqtare, Fildez Hafizi, gjykata dënon me burgim të përjetshëm Fadil Kasemin

TIRANË - Fadil Kasemi, i cili në gusht të vitit 2017 ekzekutoi ish-bashkëshorten e tij gjyqtare, Fildez Hafizi është dënuar dje me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Gjatë seancës gjyqësore, 54-vjeçari është shprehur se ishte penduar dhe se nuk do ta bënte vrasjen po të kthehej koha pas. Ndërsa avokati Ila Ilija ka kërkuar lehtësimin e masës së dënimit, duke kërkuar nga gjykata një dënim me 25 vite burg, trup gjyqësor dhe dënimin maksimal për vrasësin e gruas së tij. Me 27 dhjetor, Prokuroria e Krimeve të Rënda dha pretendencën për Kasemin,

FËMIJËT

Në seancat gjyqësore për vrasjen e ndodhur në gusht të 2017-ës, fëmijët e çiftit fajësuan babain për divorcin, duke e konsideruar atë të dhunshëm dhe kërkuan dënim maksimal të tij. Procesi gjyqësor kaloi disa herë nga një gjykatë në tjetrën për çështje kompetencash. 39-vjeçarja u qëllua me pistoletë brenda makinës së saj nga Kasemi. Për shkak të kërcënimeve kishte siguruar edhe një urdhër mbrojtje, por kjo nuk e pengoi ish-bashkëshortin të ndërmerre krimin e rëndë.

burgim të përjetshëm dhe kërkoi ta vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë. 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumba pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Seanca për dhënie të vendimit ishte caktuar më 8 janar, por u shty

pasi pala mbrojtëse kërkoi më shumë kohë për të këqyruar dosjen. Me 27 dhjetor, Prokuroria e Krimeve të Rënda dha pretendencën për Kasemin, i cili vrau gjyqtaren Fildez Hafizi. Prokuroria kërkoi burgim të përjetshëm për



Kasemin, dënim që duhet ta vuajë në një burg të sigurisë së lartë. Kujtojmë se gjyqtarja Fildez Hafizi u vra më 31 gusht 2017 nga ish-bashkëshorti i saj, 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumba pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Ky duket se ishte fundi i një kronike të parajlmëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse kishte marrë një urdhër mbrojtje, gjyqtarja merrte kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshorti. Ky duket se ishte fundi i një kronike të parajlmëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse

kishte marrë një urdhër mbrojtje, gjyqtarja merrte kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshorti. Ky duket se ishte fundi i një kronike të parajlmëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse kishte marrë një urdhër mbrojtje, gjyqtarja merrte kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshorti.



Apeli liron nga burgu ish-trajnerin e Kombëtares, Armir Grima

TIRANË - Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka ndryshuar masën e sigurisë për ish-portierin e Vllaznisë dhe ish-trajnerin e Kombëtares së Femrave, Armir Grima, i cili arrestua në shtator të vitit që shkoi në kuadër të megaoperacionit "Oaz" si pjesë e grupit kriminal të Safet Bajrit. Ndërkohë që prokuroria kërkoi lënimin në masën e arrestit me burg, Grima ishte pjesë e grupit prej 11 personash të arrestuar në operacionin policor "Oaz" të shtrirë në Tiranë, Shkodër, Roterdam dhe Holandë. Grima ka qenë portier i ekipit të futbollit të Vllaznisë në vitet 1998-2001, kohë kur ky ekip është shpallur kampion. Ai ka qenë edhe drejtor teknik i skuadrës, ndërsa ka mbajtur herë pas here edhe pozicionin e trajnerit në momentet kur Vllaznia ka pasur probleme. Armir Grimaj është zbuluar rastësisht nga përgjimet telefonike dhe akuzohet për trukim ndeshjesh. Ndeshja, për të cilën akuzohet trajneri i Kombëtares së Femrave, Armir Grimaj, është ajo e luajtur më datën 5 maj të vitit 2018 mes Vllaznisë B dhe Tërbunit. Ndeshja ishte përcaktuese për Vllazninë B, e cila kërkonte që të mbijetonte në Kategorinë e Parë, në grupin B të saj.

Në skemën e mashtrimit 20 kompani fiktive, i shkaktuan shtetit dëm prej 18 mld lekësh

Evazion fiskal me TVSH-në, në pranga 13 persona dhe 12 të tjerë në kërkim

TIRANË

13 persona kanë përfunduar në pranga dhe 12 të tjerë janë shpallur në kërkim, pasi akuzohen për evazion fiskal me TVSH-në. Pas hetimeve të para të Drejtësisë së Hetimit Tatimor të DPT Tiranë, prokuroria e kryeqytetit ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të krijimit të skemave mashtruese me qëllim kreditimitin e TVSH. Në vijim nga organi i akuzës janë lëshuar 25 urdhër ndalime për 25 persona që figurojnë administratorë të subjekteve të dyshuara fiktive që kanë lëshuar fatura të falsifikuara për subjekte të treta, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm prej 18 miliardë lekësh. Hetimet vijojnë për identifikimin e saktë e të plotë të subjekteve përfitues të skemës mashtruese. Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" ka zbardhur dosjen e hetimit të 25 personave për evazion fiskal. Sipas Prokurorisë së Tiranës, rezultoni se në këtë skemë janë të përfshirë 20 kompani dhe 4 studio kontabiliteti, administratorët e të cilëve janë vënë në ndjekje penale. Për të përfunduar kompensimin e TVSH-së, të akuzuarit dyshohet se kanë regjistruar subjekte tregtare në mënyrë fiktive, pa asnjë lloj aktiviteti, me qëllim tërheqjen e blloqeve Tatimore të TVSH-së, duke lëshuar fatura fiktive TVSH-je shitjeje. Subjektet tregtare kryenin blerje fiktive nga kompani që operonin në fushën e tregtisë së produkteve ushqimore dhe më pas i shisnin po në mënyrë fiktive në kompani që operonin në fushën e ndërtimit. E thekshëm më



REAGIMI I RAMËS

Pas arrestimit të 13 personave dhe shpalljes në kërkim të 12 të tjerëve nën akuzën e evazionit fiskal, ka reaguar kryeministri Edi Rama. Përmes një postimi në "Facebook", ai theksoi se ulja e taksave synon edhe uljen e informalitetit dhe evazionit fiskal. Ndërsa pohoi se arrestimi i një dizjine shkelësisë është mesazh i qartë: "Mos luani me taksat se ju gjen belaja".

thjeshtë, kompanitë regjistronin si shembull, blerje djathi, qumështi, kosi e të tjera produkte ushqimore, që më pas ua shisnin kompanive që vepronin në fushën e ndërtimit. Në të vërtetë, në gjithë zinxhirin e transakcioneve nuk ka pasur asnjë produkt real në mes por ekzistonte vetëm në faturë. Më pas, kjo faturë i shitej një

tjetër kompanie e kështu me radhë deri kur faturat fiktive dorëzoheshin tek Drejtoria e Tatimeve, ku tërhiqej rimbursimi prej 20 për qind i TVSH-së për çdo blerje që ishte kryer. Sipas skemës së dytë, nga të dhënat e hetimit tatimor, rezultoni se të gjitha subjektet ishin të lidhura me njëra-tjetrën për të punësuarit. Kështu, sipas listëpagesave

KOMPANITË DHE BIZNESMËNËT NËN HETIM	
■ "KRIST-AL CONSTRUCTION"	Administratore R.S.I & T Group
■ Arsen Roci	Lirim Jella
■ Administrator Aleksandër Gusho	Administrator Robert Shabani
■ "ÇAÇI"	Ish administrator AL-BER CO&CO
■ Arsim Gaci	Esmeralda Ciftligu
■ Administrator	Administratore Sentilano Cifliku
■ "UELSI"	Ish administrator
■ Dritan Cungu	■ "JONUFRI"
■ Administrator	Myfaret Ballushi
■ "SULA & LEO"	Administrator
■ Bruno Osmani	■ "SIM 2B"
■ Administrator	Gentjan Dedja
■ Anida Brahimi	Administrator
■ Ish administrator Eriisa Islam	■ "RI-GRE 96"
■ Administrator Erald Sotiri	Rigerta Bakjasi
■ Ish administrator	Administratore
■ "BRUNA AL"	■ "BLE-ME-18 INVEST"
■ Luan Muka	Bledar Metko
■ Administrator	Administrator
■ Petrika Treska	■ "EZ&LA"
■ Ish administrator	Emiljano Frokro
■ Gerdj Lano	Administrator
■ Ish administrator	■ "NADA 2005"
■ "UFI 02"	Diana Ramizi
■ Kudret Memaga	Administratore
■ Administrator	■ "FROGY 03"
■ "ORI"	Vladimir Sheshi
■ Kristi Rrënjia	Administrator
■ Administrator	■ "Leli 17"
■ LUMI 06	Enver Sheshi
■ Lumturije Murati	Administrator
■ Administrator	■ "O&B INVEST"
■ Naxhire Gurakuqi	Gëzim Disha
■ Ish administrator	Administrator
■ "AA-117"	Astrit File
■ Drita Frangaj	Ish administrator

në historikun e punonjësve, i njëjti person në të 20 kompanitë rezultoi në funksione të ndryshme, njëherë si administrator dhe në një moment tjetër rezultoi si shofer, magazinier, pastrues apo punëtor krahu. Të njëjtët punonjës kanë qarkulluar si të punësuar në kohë të ndryshme në funksione të ndryshme në të njëjtat subjekte. Kjo skemë

është përdorur për të krijuar idenë se 20 kompanitë ishin reale dhe po ushtronin aktivitetin të rregullt ligjor. Në fakt nga hetimet rezultoi se asnjë prej subjekteve nuk ka kapacitetet e nevojshme njerëzore për të kryer aktivitetin e regjistruar. Të arrestuarit për mashtrim me skemën e TVSH-së-së rrezikojnë sipas ligjit 3 deri në 10 vite burg.

Sherr në një lokal, vritet me plumb në kokë i riu

KORÇË - Një person është vrarë mbrëmë me armë zjarri në qytetin e Korçës. Mësohet se ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:25, në lagjen nr. 10 të këtij qyteti. Nga raportimet paraprake, dyshohet se është ekzekutuar një 30-vjeçar, ende i paidentifikuar. I riu ka humbur jetën rrugës për në spitalin e Korçës, ku po transportohej menjëherë pas ngjarjes. Dyshohet se para ngjarjes ka pasur sherr në një lokal mes viktimës dhe autorit. Ndërkohë, forca të shumta policie kanë shkuar në vendin ku ka ndodhur krimi në periferi të qytetit të Korçës, të cilat po punojnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe kapjen e autorit.

PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Ngujim edhe në universitetin e Durrësit/ Pedagogët dalin në krah të të rinjve

Voltiza Duro

Disa prej studentëve të universiteteve publike në vend vazhdojnë bojkotimin e mësimit dhe ngujimin brenda godinave të fakulteteve, deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Ata shprehen të vendosur në qëndresën e tyre dhe theksojnë se nuk do të heqin dorë deri në rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë. Ditën e djeshme, studentët e Ekonomikut kanë votuar masivisht për bojkotimin e mësimit, në një kohë që dekani i këtij fakulteti ka theksuar se mësimi vijon normalisht. "Ne si studentë do të vazhdojmë bojkotin e mësimit, pavarësisht pallavrave të drejtuesve të institucionit. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", thekson një prej studentëve të Ekonomikut për "Gazeta Shqiptare". Aktualisht ngujimi po vijon në Fakultetin e Drejtësisë, Shkencave Sociale, Shkencave të Natyrës, Universiteti Bujqësor, Politeknik e Fakulteti i Gjeologji-Minierave. "Mësim nuk ka pasur. Ne jemi shprehur edhe më parë që deri në

Studentë në fakultete të ndryshme votojnë pro vazhdimit të bojkotit të mësimit

"Nuk tërhiqemi deri në plotësimin e kërkesave"



VOTIMI

Ditën e djeshme, studentët e Ekonomikut kanë votuar masivisht për bojkotimin e mësimit, në një kohë që dekani i këtij fakulteti ka theksuar se mësimi vijon normalisht. "Ne si studentë do të vazhdojmë bojkotin e mësimit, pavarësisht pallavrave të drejtuesve të institucionit. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", thekson një prej studentëve të Ekonomikut për "Gazeta Shqiptare".

9 plotësimin e kërkesave tona, përfshirë këtu edhe rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë, ne nuk do të dorëzohemi. Jemi këtu derisa zëri ynë të dëgohet", - thekson një studente e Fakultetit të Histori-Filologjisë në UT. Edhe Arkitektura dhe Urbanistika si dhe Inxhinieria e Ndërtimit kanë vendosur të vazhdojnë bojkotin. "Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe të Inxhinierisë së Ndërtimit kanë zgjedhur një proces transparent dhe demokratik për të vendosur nëse do të vazhdojnë bojkotin apo do të rik-

thehen në mësim. Përmes votimit, 62% e studentëve të EAU dhe 58% e studentëve të FIN kanë shprehur vullnetin e tyre për të vazhduar bojkotin deri në plotësimin e kërkesave dhe abrogimin e ligjit për arsimin e lartë. Rezistenca vazhdon", - bëjnë me dije studentët. Ndërkohë, pedagogët e Shkencave Politike-Juridike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, kanë dalë në mbështetje të plotë të kërkesave të studentëve dhe kërkojnë abrogimin e ligjit për arsimin e lartë. Sakaq, studentët e UAMD-së vazhdojnë ngujimin brenda godinës së Korpusit Universitar.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

SUPPLY OF STAFF UNIFORMS TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: kzoraqi@tirana-airport.com; srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com specifying, request for information for "Supply of staff uniforms".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

This tender will be organized in two phases:

- In the first phase companies will need to present similar works through uniform samples performed for other companies, letter of references and also a sample of the proposed materials.
- In the second phase short listed companies will need to submit their financial offer together with the sample for Tirana International Airport.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **16:00 hrs. on 25 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:

kzoraqi@tirana-airport.com
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

Invitation to Quote (ITQ)

Albania

World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project; 8521-AL

"Goods-IT equipment for ADISA (tablets for institutions live citizen mechanism)"

Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04

1. The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development¹ towards the cost of Citizen Centric Service Delivery Project and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for "Tablets for institutions live citizen mechanism"; Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04.

The purpose is to purchase 100 tablets that will be installed and mounted on the wall by the economic operator, in the context of receiving citizen feedback for public services provided by public institutions.

2. The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites to quote with regard to the items under this Invitation. Price quotations will be evaluated for all the items together and contract will be awarded to the firm offering the lowest evaluated total cost of the items. The prices should be quoted in ALL (Albanian Lek) for the Total Cost which includes all taxes, VAT, customs, duties, inland transportation and insurance, loading and unloading.

3. The full Invitation to quote document including Technical Specification may be found to ADISA website (www.adisa.gov.al) or requested at the emails below by interested suppliers. Quotation may be submitted by official mail, or electronically at the following address:

ADISA

Bldv: Zhan d'Ark,

Ish shtepia e oficerave, Kati V-te

Tirana, Albania

e-mail: roland.larashi@adisa.gov.al;

and also fiorentina.jorgji@adisa.gov.al; informacion@adisa.gov.al

Interested suppliers may obtain further information at the same addresses.

4. The deadline for submission of Quotation is January 31 2019, 12:00 local time.

PUNA NË SHQIPËRI PROBLEMATIKAT

"Minierat, nga 10 mijë punonjës, vetëm 2 mijë paguajnë kontribut suplementar"

Informaliteti në punë, Nikollaj: Tatim-taksat, jotransparentë

"Nuk deklarohen pagat reale të të punësuarve"

Voltiza Duro

Puna në të zezë, pagesa jo të deklaruar në masën reale dhe paga minimale të pamjaftueshme për qytetarët kanë qenë e vazhdojnë të jenë disa nga problematikat kryesore në tregun e punës. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', kreu i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj tregon se qeveria ka qenë dorështrënguar në drejtim të pagës minimale dhe ka favorizuar më së tepërmi biznesin, sesa punonjësien e thjeshtë. Ai thekson se punëdhënësit po përdorin metoda të ndryshme informaliteti duke mos deklaruar realisht pagën e punonjësve, duke punuar me dy palë listë-pagesa, duke ju tërhequr një pjesë punë-marrësve pasi ata të tërheqin pagën në bankomate. Nikollaj akuzon institucionet shtetërore përgjegjëse se shpesh punojnë secili për hesap të vet dhe duke krijuar premisa për korrupsion. Kreu i KSSH bën me dije se tatim-taksat punojnë pa transparencën e duhur, raketdojnë e raportojnë me shumë vonesë (shpesh edhe pas një viti), për subjektet që nuk kanë paguar sigurimet shoqërore.

Sa është numri i punonjësve me kontribute në vendin tonë?

Zhvillimi i sistemeve të mbrojtjes sociale në përgjithësi dhe veçanërisht ai i Sigurimeve Shoqërore ka qenë dhe mbetet prioriteti i axhendës së punës së Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. Zhvillimet ekonomike të viteve të fundit si dhe tendencat e zhvillimeve demografike evidentojnë marrjen e masave urgjente për konsolidimin e këtyre skemave të mbrojtjes sociale, jo vetëm me fuqizimin e tyre monetar, por edhe me ndërhyrje dhe rregullime ligjore të domosdoshme me efekte afat-mesme dhe afatgjata për të siguruar një mbrojtje sociale cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Numri i



Kreu i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj

kontribuesve në skemën e ISSH-së, në vitin 2018 ishte rreth 765.000 persona ku vetëm 60.000 persona janë kontribues rural ndërsa pjesa tjetër janë kontribues urban.

Sa qytetarë përfitojnë pension dhe si paraqitet raportit përfitues-kontribues?

Ndërkohë numri i përfituesve është rreth 635.000 ku në zonat rurale përfitojnë pension rreth 140.000 persona ndërsa pjesa tjetër janë përfitues urban. Nga këto të dhëna duket qartë se në zonat rurale kemi shumë pak kontribues në raport me përfituesit, kjo tregon dhe lidhet direkt me shkallën e varfërisë në vend. Pavarësisht frymës pozitive që solli reformimi i skemës së pensioneve në vitin 2015, akoma raportit kontribues/përfitues është shqetësues (1,53 me 1). Shqetësues vazhdon të jetë numri i madh i pensioneve të reja të lidhura në një vit (rreth 35.000 në vit) me numrin e të rinjve që futen në tregun e punës rishtas. Këtyrë shqetësimi i shtohet edhe rritja e moshës mesatare ku koha e gëzimit të pensionit aktualisht është rreth 24 vite.

Si e vlerësoni masën e pagës minimale, a është e mjaftueshme për shqiptarët?

Problem tjetër që lidhet me mbrojtjen sociale dhe shkallën e varfërisë është edhe paga minimale në shkallë vendi, e cila përcaktohet me ligj. Për këtë duhet të harmonizohen kërkesat morale (të cilat lidhen me nevojat jetësore të punëtorëve) dhe kërkesat ekonomike (të cilat lidhen me rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe me produktivitetin e saj. Vetëm ky harmonizim bën të mun-

hasohet me nevojat e popullatës apo me minimumin jetik, i cili fatkeqësisht pranohet por nuk shpallet zyrtarisht.

Sa deklarohet paga reale e punonjësve nga punëdhënësit?

Nisur nga konflikti ndërmjet produktivitetit të ulët në punë dhe kërkesës së vazhdueshme të punëtorëve për rritje page minimale, punëdhënësit kanë shpikur metoda të ndryshme infor-

INFORMALITETI

Institucionet shtetërore përgjegjëse shpesh punojnë secili për hesap të vet dhe duke krijuar premisa për korrupsion.

Ristrukturimet e shpeshta organizative të hallkave të qeverisë, më shumë kanë sjellë dhëm sesa produktivitet në eliminimin e fushës së zezë dhe informalitetit.

dur rrajtjen e ekuilibrit social. Këto vite, qeveria ka qenë dorështrënguar në drejtim të pagës minimale duke e hequr "valen sipas muzikës së biznesit", pavarësisht presionit të sindikatave. Nga 1 janari i 2019 paga minimale u bë 149 lekë/orë pune ose për 174 orë pune/mujore ajo u bë 26.000 mijë lekë në muaj. Rritje kjo jo e konsiderueshme po të kra-

maliteti shpesh edhe të sofistikuar duke mos e deklaruar realisht pagën e punonjësve, duke punuar me dy palë listë-pagesa, duke ju tërhequr një pjesë punë-marrësve pasi ata të tërheqin pagën në bankomate. Këto vitet e fundit po përdoren disa metoda të sofistikuar si: mosrritja e pagës, por dhënia e disa herëve gjatë vitit; shpër-



Foto ilustruese

ARSYEJA

Gjatë periudhës 6-12 vjeç mbizotëron kryesisht të menduarit konkret kurse më pas ai abstrakt. Me strukturën aktuale, ku cikli fillor zgjat pesë vjet, nisim më herët nga sa duhet dozat e të menduarit abstrakt. Struktura e re 6+3 parashikon shmangien e kësaj forme të menduarit.

blime honorare në formë benefiti që i lidhin me performancën pozitive të ndërmarrjes por kjo bëhet për të shmangur tatimet dhe taksat mbi vlerën reale të pagës. Metodë tjetër abuzuese është edhe dhënia e pagës në natyrë, jo me mjete monetare edhe kjo kryhet me qëllim që të mos paguhen siguracionet edhe taksat. Këto fenomene janë shqetësues jo vetëm në ndërmarrjet tradicionale që paguajnë page minimale, si fasoneria, turizmi, security (policia private), por edhe në ndërmarrjet industriale si: fabrika përpunimi, minierat, ndërtim, transport, shëndetësia private, profesionet e rregulluara etj.

Sa është numri i punonjësve të padeklaruar, po në industrinë e nëntokës si paraqiten shifrat?

Për sa i përket informalitetit në tregun e punës, akoma vazhdon të jetë shqetësues. Institucionet shtetërore përgjegjëse shpesh punojnë secili për hesap të vet dhe duke krijuar premisa për korrupsion. Ristrukturimet e shpeshta organizative të hallkave të qeverisë, më shumë kanë sjellë dhëm sesa produktivitet në eliminimin e fushës së zezë dhe informalitetit. Në industrinë e lehtë përpunuese qoftë ato të fasoner-

isë apo edhe të agro-biznesit kemi një informalitet të padeklaruar shqetësues. Do të sjell në vëmendje vetëm informalitetin që është sot në sektorin privat minierar. Prej tre vitesh kontributet e këtij sektori janë rritur me 5%, me qëllim që të kompensohet ulja e moshës së tyre për të dalë në pension. Aktualisht punojnë rreth 10.000 punonjës në këtë sektor dhe pagesën suplementare prej 5% e paguajnë vetëm 2000 punonjës nëntokë. Kjo është një minë me sahat për pensionet e ardhshëm të tyre.

A ndikon në këtë informalitet edhe puna e tatim-taksave?

Shkak tjetër për evazion fiskal dhe punë të padeklaruar, është edhe mosraketimi i tatim-taksave me Sigurimet Shoqërore. Fatkeqësisht tatim-taksat punojnë pa transparencën e duhur, raketdojnë e raportojnë me shumë vonesë (shpesh edhe pas një viti), për subjektet që nuk kanë paguar sigurimet shoqërore, siç kanë qenë rastet me punonjësit e naftës apo edhe të disa kompanive shtetërore dhe institucioneve Publike të pushtetit vendor dhe qendror, që kur kanë vështirësi likuidimi, sakrifikojnë fillimisht kontributet e punonjësve.



Voltiza Duro

Në vendin tonë, shpeshherë punonjësit denoncojnë raste të pushimit nga puna për shkak të rotacioneve politike. Ndërkohë, kontratat individuale, jo rrallëherë nuk nënshkruhen nga i punësuar i ose thjesht mund të firmohen sa për formalitet. Kreu i KSSH-së, Kol Nikollaj thotë për 'Gazeta Shqiptare' se instrumentet e kontrollit janë sipërfaqësore dhe shpesh të kapur nga biznesi e ndërkohe ky i fundit në cilësinë e punëdhënësit është i paorganizuar në organizata punëdhënësive efektive. Ai thekson se aksidentet në punë ndodhin kryesisht në Industrinë e Rëndë, nxjerrëse dhe përpunuese si dhe në ndërtim e Telekomunikacion, ndërsa sektorët më të ekspozuar këto vite kanë qenë minierat dhe energjika, kjo jo vetëm për efekt të riskut të lartë, por edhe nga mungesa e përgjegjësisë njerëzore.

A nënshkruajnë kontrata pune punonjësit në Shqipëri dhe sa respektohen pikat e saj?

Problemi i kontraktimit kolektiv e individual të punës në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem i pazgjidhur, kjo për arsye se ne jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi ligj të posaçëm për "Organizimin dhe funksionimin sindikal dhe kontraktimin kolektiv". Kodi i punës i jep prioritet kontraktimit individual por gjithmonë nuk mund të jete i suksesshëm nëse nuk mbështetet në një kontraktim kolektiv solid dhe gjithëpërfshirës. Kontratat individuale të punës, akoma vazhdojnë të hartohen në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi dhe të nënshkruhen në mënyrë formale nga punëmarrësi. Instrumentet e kontrollit janë sipërfaqësore dhe shpesh të kapur nga biznesi. Edhe biznesi vetë në cilësinë e punëdhënësit është i paorganizuar në organizata punëdhënësive efektive e për rrjedhojë i mungon inteligjencia për të investuar në kapitalin njerëzor. Investimi në kapitalin njerëzor është "thembra e Akilit" për rritjen e performancës të produktivitetit të kompanive private e publike. Kjo bëhet e mundur vetëm nëse kontraktimi individual i punës hartohet, negociohet e nënshkruhet në përputhje e në zbatim të plotë të ligjit dhe me mbështetjen, konsulencën e avokatit dhe sindikatave si përfaqësuese legjitime të punëmarrësve. **Po kushtet e punës si paraqiten, veçanërisht në**

Kreu i KSSH: Inspektorati i Punës, 95 inspektorë me 3 makina në të gjithë vendin

"Kontratat individuale të punës firmosen thjesht për formalitet"

Nikollaj: Kushte jodinjitoze për punëmarrësit



PROBLEMI
Problemi i kontraktimit kolektiv e individual të punës në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem i pazgjidhur, kjo për arsye se ne jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi ligj të posaçëm për "Organizimin dhe funksionimin sindikal dhe kontraktimin kolektiv". Kodi i punës i jep prioritet kontraktimit individual por gjithmonë nuk mund të jete i suksesshëm nëse nuk mbështetet në një kontraktim kolektiv solid dhe gjithëpërfshirës.



Ministria e re e Financave dhe Ekonomisë: Do të thellohet lufta ndaj informalitetit

Ditën e djeshme, ministria e re e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, ka paralajmëruar se do të thellojë luftën e nisur kundër informalitetit. Në prononcimin e saj të parë për mediat, Denaj ka theksuar, gjithashtu, se do të përmirësojë më tej edhe marrëdhëniet me biznesin. Ndërkohë, në marrjen e detyrës së re, Denaj ka përgëzuar ish-ministrin e Financave, Arben Ahmetaj, për punën e bërë gjatë gjithë periudhës që ka drejtuar këtë ministri. "Unë jam shumë e nderuar që më jepet kjo mundësi për të drejtuar një dikaster shumë të rëndësishëm. Besoj që ekuilibrat mund të mbahen në kontroll vetëm nëpërmjet një formati dhe një balance ligjore. Të thellohet lufta e nisur kundër informalitetit dhe të përmirësohen më tej marrëdhëniet me sipërmarrjen", tha ministria e re e Financave dhe Ekonomisë.

sektorët me vështirësi të lartë si minierat?

Kushtet e punës janë pjesë e realitetit social, ekonomik dhe kulturor të vendit. Nuk mund të flitet për kushte djinjitoze dhe perfekte në një vend me konflikte politike, sociale, me kulturë të mangët negociimi dhe bashkëpunimi, me dukuri të shfaqura dukshëm të korrupsionit dhe influencave të trafikimit politik etj. Pavarësisht se ne kemi një ligj të arrirë për sigurinë dhe shëndetin në punë zbatim i tij është shumë larg. Akoma ne nuk kemi një Këshill Kombëtar të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Pavarësisht që ligji kërkon ngritjen e sigurisë dhe shëndetit në punë, në ndërmarrje ato nuk funksionojnë. Sëmundjet profesionale po bëjnë kërdinë dhe

MASAT

Qeveria duhet të ulet me partnerët socialë dhe të nënshkruajnë një Memorandum bashkëpunimi social që të përfshijë ide, mendime dhe afate konkrete për të kapërcyer situatën e vështirë sociale-ekonomike që ndodhet vendi ynë.

fakti i sigurisë për vendin e punës sidomos në Administratën Publike, ku këto ditë ne jemi njohur me përgjime të kryera në Drejtorinë e Burgjeve, por pjesë e këtij realiteti janë kompani dhe institucione publike si dhe hallkat e pushtetit vendor dhe qendror, të cilat në rotacione politike apo në rotacione drejtuesish ekzekutiv masakrojnë punonjësit duke i larguar pa shkak nga

e rëndë, nxjerrëse dhe përpunuese si dhe në ndërtim e telekomunikacion. Sektorët më të ekspozuar këto vite kanë qenë minierat dhe energjetika. Kjo ka ardhur jo vetëm për efekt të riskut të lartë por edhe nga mungesa e përgjegjësisë njerëzore. Shkrirja e Ministrisë së Punës, varësia e saj nga Ministria e Financave si dhe kalimi i varësisë së Inspektoratit Shtetëror dhe të përkujdesjes shoqërore nga Ministria e Financave kanë qenë shkaqe negative që kanë larguar përgjegjësinë dhe kanë motivuar papërgjegjshmërinë njerëzore në drejtim të eliminimit të aksidenteve në punë goftë me gjymtime të pjesshme apo me marrje jete. Vakumi ligjor dhe moskoordinimi i agjencive ligj-zbatuese Shtetërore si RISHMI, AKBN, ISHPPSH, Prokuroria, Gjykatat, kanë bërë që gjithmonë përgjegjësia të ngelet te viktimat.

Cilat janë masat që duhen marrë nga Instancat përgjegjëse për t'i dhënë zgjidhje problematikave të mësipërme?

Ne mendojmë se urgjencisht qeveria duhet të ulet me partnerët socialë dhe të

VESHITRESITË

Sëmundjet profesionale po bëjnë kërdinë dhe askush nuk i evidenton dhe nuk i studion. Nuk kryhen vizita mjekësore periodike konform ligjit dhe punonjësit janë të papajisuar me kartela personale mjekësore.

askush nuk i evidenton dhe nuk i studion. Nuk kryhen vizita mjekësore periodike konform ligjit dhe punonjësit janë të papajisuar me kartela personale mjekësore.

Sa i sigurt është punonjësi për vendin e punës, veçanërisht pas rotacioneve politike?

Shqetësues mbetet edhe

puna. Janë me qindra e mijëra procese gjyqësore që presin ekzekutimin në favor të punonjëse ku buxheti i shtetit penalizohet me qindra e mijëra euro.

Cilët janë sektorët më të ekspozuar ndaj aksidenteve në punë?

Aksidentet në punë ndodhin kryesisht në industrinë

nënshkruajnë një Memorandum bashkëpunimi social që të përfshijë ide, mendime dhe afate konkrete për të kapërcyer situatën e vështirë sociale-ekonomike që ndodhet vendi ynë. Ndërsa në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të reformohen tërësisht strukturat shtetërore të cilat e kanë detyrim kushtetues dhe ligjor sigurinë dhe shëndetin në punë. Konkretisht në mënyrë urgjente duhet ndërhyrë tek Inspektorati i Punës, i cili duhet të bëjë kthesë rrënjësore në këtë fushë. Një Inspektorat me 95 inspektorë që me tre automjete lëvizëse, është qesharake të mendojmë se kontrollojnë dhe mbikëqyr gjithë subjektet punuese në gjithë territorin e vendit. Pa folur pastaj për minierat në të cilat ky inspektorat nuk futet brenda në nëntokë, për kontroll apo inspektim. Ndërmarrjet minerare dhe ato ujore janë ligjërisht jashtë kontrollit nga shteti. Këtë detyrim ligjor ia kalojnë goja RISHMI-t që është agjenci tjetër shtetërore që ka funksion kontrollin e sigurisë teknike në miniera si agjenci e specializuar dhe jo kushtet e punës së punonjëseve në tërësi. Këto dy institucione shtetërore kështu të ndara nuk kryejnë asnjëra funksionin e vërtetë, atë të evidentimit dhe parandalimit të rreziqeve në miniera në tërësi dhe rrezikun e jetës në veçanti. Prandaj, këtu duhen bërë ndërhyrje ligjore dhe të punohet për përfundim kapacitetesh njerëzore.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Ministria e Financave publikon procedurën dhe dokumentet që nevojiten për të marrë dëmshpërblimin

Të përndjekurit, si do ndahet kësti i 10

Radha e ndarjes së parave, në fillim gratë dhe personat mbi 75 vjeç

Ministria e Financave ka nisur dhënien e kështit të dhjetë për kategoritë parësore, që janë pjesë e skemës së dëmshpërblimit si ish-të dënuar politikë. Urdhri i ri parashikon procedurën, dokumentet dhe radhën si do jepen paratë për këstin e 10-të me fondin e ri që Ministria e Financave ka në dispozicion për vitin 2019.

NJOFTIMI I PLOTE

Në zbatim të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 419, datë 14.04.2011, "Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuar politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se ka filluar procedurën e pagesës së kështit të dhjetë për kategorinë e subjekteve përfutuese parësore, me Urdhrin nr. 17, datë 11.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

VENDIMI

Në zbatim të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 419, datë 14.04.2011, "Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuar politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se ka filluar procedurën e pagesës së kështit të dhjetë për kategorinë e subjekteve përfutuese parësore, me Urdhrin nr. 17, datë 11.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

fituese, të cilat janë pjesë e nënkategorisë së parë dhe të dytë, duhet të paraqiten në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të plotësuar Deklaratën Personale të Aplikuesit, me qëllim mundësimin e printimit të certifikatës së tyre personale nëpërmjet portalit të ofrimit të shërbimeve të qytetarëve 'online', "e-Albania". Gjithashtu, këto subjekte duhet të deponojnë pranë zyrave tona numër llogarie bankare në Lekë në njërin nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (personat që deponojnë numrin e llogarisë bankare duhet që të sigurohen që llogaria bankare, në të cilën do të deponizohet kësti i radhës, të jetë ende aktiv).

Për nënkategorinë e tretë parësorë ish-të dënuar politikë, të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda, dokumentet që duhet të deponizojnë janë:

-Deklarata Personale e Aplikuesit.

-Numër llogarie bankare në Lekë në njërin nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (personat që deponojnë numrin e llogarisë bankare duhet që të sigurohen që llogaria bankare, në të cilën do të deponizohet kësti i radhës, të jetë ende aktiv).

-Vendimi i KMCAP, (KEMP-i epror), i cili vërteton humbjen e plotë të aftësisë për punë, origjinale. Vendimi duhet të jetë plotësuar saktë, me shkrim të lexueshëm, pa korrigjime, duhet të ketë të shkruar emrin/mbiemrin e



anëtarëve të KMCAP dhe nënshkrimin e tyre me vulën e komisionit.

-Epikrizë për sëmundje onkologjike, malinjje dhe sëmundje të gjakut të pashërueshme të lëshuara nga: Qendra Shëndetësore Universitare "Nënë Tereza", Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Spitali Universitar "Mbretëresha Geraldinë", Spitali Universitar "Koço Glozheni". Kjo epikrizë përgatitet nga mjeku që trajton të sëmurin, nënshkruhet me emrin dhe mbiemrin e mjekut kurues. Shefi i Shërbimit vërteton saktësinë e diagnozës dhe e nën-

shkruan këtë dokument dhe në fund, epikrizja firmoset nga drejtuesi i institucionit shëndetësor me vulën përkatëse. Për kategorinë e katërt parësorë ish-të dënuar politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët pavarësisht nga mosha, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dokumentet që duhet të dërgojnë janë:

-Deklarata Personale e Aplikuesit.

-Numër llogarie bankare në Lekë në njërin nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të

Republikës së Shqipërisë (Personat që deponizojnë numrin e llogarisë bankare duhet që të sigurohen që llogaria bankare, në të cilën do të deponizohet kësti i radhës, të jetë ende aktiv).

-Certifikatë familjare ku të përfshihet fëmija i mitur;

-Certifikatë personale të fëmijës/fëmijëve të mitur.

Për kategorinë e pestë parësorë, ish-të dënuar politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dokumentet që duhet të dërgojnë janë:

-Certifikatë vdekjeje e ish-të dënuar politikë.

-Certifikatë e tringut familjar të ish-të dënuar politik, ku të përfshihen: fëmija/fëmijët e mitur.

-Certifikatë personale e të miturit/miturve, trashëgimtarë të radhës së parë të ish-të dënuar politik që nuk jeton.

-Dëshmi trashëgimie për ish-të dënuar politikë, origjinale ose kopje e noterizuar.

-Vendim Gjykatë të kujdestarisë mbi të miturin në rastin kur edhe nëna/babai i të miturit nuk jeton më;

-Nr.llogarie bankare në Lekë, në emër të kujdestarit ligjor të të miturit, në njërin nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (Personat që deponizojnë numrin e llogarisë bankare duhet që të sigurohen që llogaria bankare, në të cilën do të deponizohet kësti i radhës, të jetë ende aktiv).

-Dokument identiteti

TË ÇREGJISTRUARIT

Ish-të dënuar politikë që jetojnë, ose trashëgimtari ligjor, të cilët figurojnë të çregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pasi kanë lënë nënshpërblyer shqiptare ose figurojnë me dy nënshpërblyer, duhet të dërgojnë një dokument identifikimi të vlefshëm.

(kopje ID-je, pasaportë) të kujdestarit ligjor.

Kur ish-i dënuar politikë që jeton ose trashëgimtari ligjor humbet zotësinë juridike për të vepruar, me vendim gjykatë i është përcaktuar kujdestari ligjor, në këto raste veprimet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë bëhen në emër të personit me këtë të drejtë. Kujdestari ligjor duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave: i). Vendimin e gjykatës mbi kujdestarinë ligjore, origjinale ose kopje e njësuar; ii). Numër Llogarie bankare në Lekë në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kujdestarit ligjor; iii). Dokument identiteti (kopje ID-je, Pasaportë) të kujdestarit ligjor; iv).Deklarata Personale e Aplikuesit.

Ish-të dënuar politikë që jetojnë ose trashëgimtari ligjor, kanë të drejtë ta delegojnë me prokurë të posaçme, tërheqjen e dëmshpërblimit financiarë. Në këto raste veprimet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kryhen në emër të personit me këtë të drejtë. Personi me këtë të drejtë duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: i).

Prokurën e Posaçme, origjinale, bashkëlidhur duhet të ketë kopje të vlefshme të dokumentit të identitetit (kopje ID-je, pasaportë) për çdo të përfaqësuar; ii). Numër Llogarie bankare në Lekë në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të tij; iii). Dokument identiteti (kopje ID-je, pasaportë) të tij; iv). Deklarata Personale e Aplikuesit.

RENDI I PAGESAVE PËR TË PËRNDJEKURIT

- 1)Ish-të dënuar politikë gra, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës.
- 2)Ish-të dënuar politikë, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
- 3)Ish-të dënuar politikë, të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm.
- 4)Ish-të dënuar politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët pavarësisht nga mosha, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
- 5)Ish-të dënuar politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
- 6)Ish-të dënuar politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshë nën 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Pas finales së Kampionatit Botëror, vjen surpriza për fansat

Era Istrefi siguron suksesin e radhës, ja ku do të performojë këngëtarja

Detaje nga eventi në Paris

Egla Xhemali

Mund të themi me plot gojën se 2018-a ishte një vit jashtëzakonisht i suksesshëm për Era Istrefin. Krahas bashkëpunimeve të suksesshme me artistë të famshëm ndërkombëtare, performanca në finalen e Kampionatit Botëror të Futbollit në Rusi, krahas Will Smith dhe Nicky Jam i dha goxha famë Erës. Duket se surprizat nuk kanë të përfunduar për fansat e saj. Kështu mësohet se këngëtarja shqiptare do të performojë në një tjetër Kupë Bote, por atë të futbollit për femra. Lajmin e ka konfirmuar e "Ussoçer Indonesia", faqja zyrtare në "Instagramin" e Federatës Amerikane të Futbollit në Indonezi dhe në të gjithë pjesën tjetër të botës. Ky eveniment për femra shënon edicionin e tij të tetë dhe do të mbahet mes datave 7 qershor dhe 7 korrik 2019, në Paris të Francës. Në përfundim të vitit 2018 bukuroshja nga Kosova paralajmëroi të



gjihtë mbështetësit e saj se shumë shpejt do të kishte surpriza prej saj. Për këtë vit të ri, Era ka pohuar se do të lançojë albumin që do të jetë pa diskutim një tjetër sukses për të. Kujtojmë se ajo ishte mes këngëtarëve më të njohur


ndërkombëtarë që kënduan himnin e Kampionatit Botëror, "Live It Up", duke bërë për vete publikun në stadium dhe ata që e ndoqën përmes ekranit. Natyrisht, ai ishte një prej çasteve më të këndshme në karrierën e

Erës, e cila do t'i japë edhe shumë më tepër muzikës ndërkombëtare në të ardhmen. Ajo e cilësoi si një nga momentet më të bukura të jetës dhe pohoi se ishte pa masë e gëzuar. Asokohe përmes një postimi në rrjetet



sociale, bukuroshja shprehu lumturinë e saj. "Performuam këngën e Kampionatit Botëror 2018 së bashku me Will Smith dhe Nicky Jam! Një moment i jashtëzakonshëm", shkroi Era në postimin e saj në "Instagram". Postimi ka marrë dh-

jetëra mijëra pëlqime, ndërsa komentuesit e uruan këngëtarën për këtë arritje profesionale të saj. Spektakli i ceremonisë përmyllëse ka vazhduar edhe me yje të tjera, në mesin e tyre edhe legjenda braziliane, Ronaldinho.




Keisi dhe Seldi bashkë? Zbuloni të vërtetën

Prej nëntorit të vitit të kaluar, Seldi kishte paralajmëruar bashkëpunimin me Keisi Meidinin, vajzën e këngëtarit Sabiani. Dhe para pak ditësh kënga e tyre "S'ka dashni" u publikua në "YouTube". Kjo këngë vjen e finalizuar edhe me videoklip, në të cilën artistët shfaqen mjaft të afert me njëri-tjetrin. E pas këtij bashkëpunimi, të shumta kanë qenë thashethemet se mes Keisit dhe Seldit mund të kishte lindur diçka, por sot tek "Ftesë në Pesë", Keisi i sqaroi njëherë e mirë të gjitha. "Seldin e kam si vëlla, jemi rritur bashkë. Kjo për shkak të lidhjes që ka pasur me babin", - u shpreh Keisi, e njohur ndryshe si e bija e Sabianit. Por, a ishte kënga "S'ka dashni" një dedikim nga ana e Seldit, për ish-partneren e tij, Mimoza Shkodra? "Duhet të pyesni Seldin", tha Keisi duke qeshur.




Janë tradhtuar? Oriola dhe Loredana paskan të njëjtin problem

Oriola Marashi dhe Loredana janë dy nga vajzat më të përfolura në "showbizz"-in shqiptar. Ndonëse njëres ia njohim pak më shumë jetën private, sepse edhe partneri i saj është një prej reperëve më të dashur për të rinjtë, për tjetrën nuk është se dimë ndonjë lidhje konkrete romantike. E megjithatë, kemi vënë re se të dyja bukuroshet e "showbizz"-it paskan të njëjtin problem me tradhtinë dhe madje, kanë një këshillë për këtë. "Nëse mendon të tradhtosh dikë që është i aftë t'ju japë çdo gjë, në fakt po tradhtoni veten nga besnikëria e vërtetë", shkruhej në shkrimin e fotos që kishin ndarë të dyja. Nuk dimë nëse vajzat kanë tradhtuar apo janë tradhtuar që japin këtë këshillë, ama duket se ndajne të njëjtin problem dhe çuditërisht kanë ndarë të njëjtën foto.



E akuzuan për ndjekësit, Luana Vjollca habiti me reagimin e saj

Këngëtarja dhe moderatoja e njohur Luana Vjollca është një nga personazhet më të përfolura të mediave rozë. Luana gjithashtu është njëra ndër femrat e "showbizz"-it më të ndjekura në rrjete sociale. Këtë e dëshmon edhe shifra më e fundit e ndjekësve të saj në rrjete sociale, e cila arrin në 1.4 milionë. Për këtë shifer, Luana ka falënderuar të gjithë ndjekësit me një fotografi të publikuar në "Instagram", për të cilët ka shkruar disa fjalë. "1.4 milionë. Mesazhi që më inspiron e marr gati çdo ditë nga ju është: Nga ti mësuam të mos heqim dorë!", ka shkruar Luana në postimin e saj. E duke qenë se ka shumë ndjekës, ka ndodhur që është "akuzuar" se një pjesë të madhe të tyre mund t'i ketë blerë. Por në këtë postim, një fans i ka treguar programin me të cilin mund të shikojë nëse një person i ka blerë fansat apo jo. Luana i ka kthyer përgjigje dhe i thotë: "Se kam provuar, por nëse ky aplikacioni funksionon, do jem shumë e lumtur se më vjen inat që po blejnë shumë e më arrijnë, unë e shkreta me zor po i bëj...". Këtë mini-bisedë bukuroshja e ka publikuar në "Instastory".



U grindën për grimierin e famshëm, ja si qëndron e vërteta e fotos së këngëtareve

Disa javë më parë bëri bujë të madhe shërrit mes dy kushërirave, Beatrix Ramosaj dhe Anxhelina Hadërgjonaj, të cilat i kishin prishur marrëdhëniet mes tyre për shkak të grimierit të famshëm Ariel. Por, së fundmi në media u përfol se dyshja kanë rregulluar marrëdhëniet, pasi në rrjet u publikua një foto ku shihej Trixa, Anxhelina dhe Ariel. Megjithatë, duket se dy kushërirat mbajnë mëri dhe ajo foto nuk është e kohëve të fundit, por para disa muajsh, ku Anxhelina erdhi dhe dha disa intervista në Shqipëri. Madje, vlen të thuhet se ende Trixa nuk ndjek dyshen Anxhelina dhe Ariel, i cili thuhet se është 'molla e shërrit' mes dyshes. Ne shpresojmë që vajzat të lenë mëritë mënjanë dhe t'i shohim sërish së bashku.



Presidenti serb: Nuk ka zgjidhje të çështjes së Kosovës pa Rusinë

Putin takon Vuçiç: Kosova po dëmton stabilitetin në Ballkan

"Themelimi i ushtrisë, veprim provokues"

Presidenti rus Vladimir Putin, aku zoi të enjten autoritetet në Kosovë për ndërmarrje veprimesh provokuese, siç është themelimi i ushtrisë që, sipas tij mund të dëmtojë qëndrueshmërinë në Ballkan.

Ai i bëri këto komente në Beograd, ku po qëndron në vizitën e tij të katërtë me radhë që nga viti 2001, në një angazhim të ri për forcimin e lidhjeve me Serbinë.

Ai u prit në aeroportin e Beogradit nga presidenti serb, Aleksandër Vuçiç, me të cilin së bashku më pas vunë kurora lulesh në "Varrezat e Çlirimtarëve të Beogradit", para se të bisedonin sy më sy e më pas edhe me delegacionet e të dyja vendeve.

Një pjesë e madhe e serbëve vlerësojnë qëndrimin kundërshtues të Moskës ndaj pavarësisë së Kosovës, që u shpall njëmbëdhjetë vjet më parë me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, Beogradi është përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën në shkëmbim të afrimit me strukturat evropiane.

Presidenti serb, tha se një pjesë e mirë e bisedimeve me presidentin rus i është kushtuar Kosovës, ndërsa theksoi se është ende larg arritjes së një marrëveshjeje me Kosovën.

Ai tha se e ka njoftuar presidentin rus për siç tha "tarifat e paligjshme të Kosovës ndaj Serbisë", pa heqjen e të cilave Serbia nuk do të vazhdojë bisedimet. Po ashtu ai tha se e ka njoftuar presidentin rus për themelimin e ushtrisë së Kosovës, ndërsa theksoi "gatishmërinë e Serbisë për bisedime e kompromis, por nuk do të lejojë përluljen e saj".

Presidenti rus tha se qëndrimi i vendit të tij është i pandryshueshëm dhe se angazhohet për një zgjidhje të pranueshme në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Ai tha se pushteti në Prishtinë ka marrë disa hapa siç është themelimi i ushtrisë së Kosovës, që sipas tij paraqet po ashtu shkelje të Rezolutës 1244. Rusia, tha ai, "e kupton shqetësimin e udhëheqjes dhe popullit serb sepse ha-



Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin dhe Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç



Putin në Beograd, serbët e presin me festë nacionaliste

Presidenti rus Vladimir Putin u prit me ceremoni solemne në një atmosferë të ngrohtë në Beograd. Putin tha se Rusia do të mbështesë përpjekjet për të ruajtur qetësinë në rajon. "Rusia, si Serbia, është e interesuar që situata në Ballkan të mbetet e qëndrueshme dhe jo e rrezikshme", u tha Putin gazetarëve në një konferencë të përbashkët të shtypit me presidentin serb Aleksandër Vuçiç.

Vizita e presidentit rus u shoqërua me një manifestim të dhjetëra mijëra serbëve që parakaluan përmes kryeqytetit në një paradë në nderi ndaj tij. "Mirëseardhje Presidenti nderuar, Putin, mik i



dashur", shkruhej në një nga pankartat e shumta nëpër qytet, ku valëviteshin flamujt rusë dhe serbë.

Parada kulmoi në kishën e madhe të Shën Savës, një nga vatrat më të mëdha të celebrimit të besimit ortodoks në Serbi.

Megjithëse Serbia aspiron të bashkohet me Bashkimin Evropian, ajo mban lidhje të ngushta historike me Rusinë, "vëllanë e madh ortodoks", me të cilin njerëzit ndajnë gjithashtu origjinën sllave.

BAZA RUSE NE SERBI

Qendra ruse që u hap fillimisht në vitin 2012, gjendet relativisht pranë forcës paqeruajtëse prej 4 mijë trupash në Kosovë. Pjesë e forcave ndërkombëtare në Kosovë janë edhe 600 ushtarë amerikanë. Moska kërkon që personelit të saj t'i jepet imunitet diplomatik, ndërsa mohan çfarëdo veprimtarie të saj përveç trajtimit të emergjencave.

pat e tillë të përpjegjshëm mund të destabilizojnë Ballkanin".

Para se të nisej për në Serbi, presidenti rus akuzoi Shtetet e Bashkuara dhe perëndimin për siç tha, destabilizimin e Ballkanit përmes politikave ekspansioniste të NATO-s.

Presidentit rus, nuk i shihet me sy të mirë proceset integruese të vendeve të Ballkanit, posaçërisht zgjerimin e NATO-s, ndërhyrja e së cilës në vitin 1999, u dha fund mizorive të forcave serbe në Kosovë.

Serbia e cila synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ruan lidhjet e ngushta me Rusinë, aleatën e saj sllave dhe ka refuzuar t'u bashkohet sanksioneve kundër Rusisë lidhur me Ukrainën dhe është zotuar të qëndrojë jashtë NATO-s.

Një nga pikat e diskutimeve për të cilën nuk u fol hapur, ishte edhe një qendër e emergjencave që Rusia menaxhon në qytetin e Nishit në Serbinë jugore.

Disa grupe perëndimore dhe analistë ushtarakë e shohin si një bazë ushtarakë të kamuflluar që Kremlin e ka ngritur për të mbikëqyrur interesat amerikane në Ballkan.

SHKURT

Mori votëbesimin e deputetëve, Tsipras: Votë "po" për Marrëveshjen e Prespës

Entuziazmi pushtoi sallën e parlamentit grek, pasi qeveria Cipras u mbështet me 151 votat e nevojshme për t'i mbijetuar mocionit të mosbesimit. Po aq i rëndësishëm ishte edhe lajmi se nga Shkupit kishte mbërritur nota verbale, me të cilën qeveria greke informohet mbi finalizimin e procesit të ndryshimeve kushtetuese, çka i hap rrugë nisjes së procedurave të miratimit të Marrëveshjes së Prespës edhe në parlamentin grek. "Nocioni "nationality" i referohet ekskluzivisht nënshtrësisë dhe nuk përcakton kombësinë. Së dyti, gjuha e fqinjëve tanë, siç është njohur nga konventa e OKB në 1977, i përket grupit të gjuhëve sllavike të jugut", tha Kryeministri grek. Cipras e bëri këtë sqarim pas lidhjes që kreu i opozitës Kyriakos Mitsotakis i bëri votëbesimit të qeverisë me votimin e marrëveshjes së Prespës. "Dua të jem absolutisht i qartë: Kush i jep votëbesimin qeverisë, voton "po" edhe për Marrëveshjen e Prespës, që përbën një lëshim të madh kombëtar". Krahas 151 votave që mori për mocionin e besimit, Cipras pritet të sigurojë edhe 4 vota të tjera parlamentare për miratimin e ndryshimeve kushtetuese.

Hashim Thaçi: Ska marrëveshje të firmosur, do takoj ekipin negociator

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka deklaruar se nuk ekziston asnjë marrëveshje e nënshkruar me Serbinë, siç përlitet në deklaratat e disa politikanëve në Kosovë. Përmes një përgjigjeje me shkrim, Thaçi tha se aktualisht ndodhet në pushime, dhe se do ta takojë Ekipin negociator qysh të hënën. "Unë në vazhdimësi i kam informuar të dy bashkëkruesuesit e Ekipit Negociator për të gjitha temat që janë diskutuar deri më tani në Bruksel, në kuadër të fazës së fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", tha Thaçi. Ekipi negociator, i përbërë nga përfaqësuesit e qeverisë dhe njëerës nga partitë opozitare, ka kërkuar ditëve të fundit që t'i ketë në dispozicion të gjitha dokumentet zyrtare që ndërlihen me procesin negociator të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel

May: Të nisin negociatat për një marrëveshje të re me BE

70 ditë nga dalja e Bashkimit European, kryeministrja britanike u bën thirrje partive për bisedime



MARRËVESHJA E RE

Kryeministrja britanike, Theresa May u ka bërë thirrje partive parlamentare për bisedime për hartimin e një marrëveshjeje të re me Brukselin. Shumica e përfaqësuesve në Dhomën e Ulët nuk e mbështetën marrëveshjen e mëhershme. Megjithatë, May mori votëbesimin për të vazhduar përpjekjet për një akord të ri, që i jep Londrës një pozicion më të favorshëm në marrëdhëniet me Brukselin, pas daljes nga Bashkimi European.

të vazhduar përpjekjet për një akord të ri, që i jep Londrës një pozicion më të favor-

shëm në marrëdhëniet me Brukselin, pas daljes nga Bashkimi European. Zërat që

mbështesin një referendum të dytë, që mund ta anulojë daljen nga unioni, po forco-

hen gjithnjë e më shumë. Deri më tani, 4 parti parlamentare kanë nënshkruar një peticion ku i bëhet thirrje Kryeministres të mbështesë një referendum të dytë për Brexit-in dhe të anulojë nënin 50, për të penguar vazhdimin e mëtejshëm të procesit të shkëputjes. Peticionin e kanë nënshkruar nacionalistët skocezë, deputetët uellsianë, liberaldemokratët dhe të gjelbrit. Këto ia kanë vënë edhe si kushte Kryeministres për pjesëmarrjen në bisedime. Të lëkundur janë edhe laboristët, të cilët zyrtarisht mbështesin një marrëveshje të re me Brukselin, por brenda tyre po shihen zërat për qëndrim në Bashkimin European.

"Bashkimi European duhet ta mbajë fjalën, ndryshe humb kredibilitetin"

Negocimi me vendet e Ballkanit Perëndimor, proces më rigoroz

Ekspertët: BE-ja ka vendosur metodologji të reja për anëtarësim

Vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas ekspertëve, në rrugën e tyre për anëtarësim në BE do të përballen me një proces më rigoroz dhe më gjithëpërfshirës. Por ai është strikt dhe korrekt me kushtëzime që duhet të realizohen. Afati i plotësimit të këtyre kushteve është tërësisht në duart e vendeve aplikuese", ka thënë Sabine Zwaenepoel, eksperte për sundim të ligjit në departamentin për zgjerim në Komisionin Evropian. Ajo i bëri këto komente në një debat me ekspertë nga shoqëria civile, ku edhe shpjegoi se BE-ja ka vendosur metodologji të reja sa i përket negociatave me vendet që dëshirojnë të futen në union. Ajo duke folur në kushtet e reja ka thënë se BE-ja gjatë negociatave fokusohet në tri aspekte të rëndësishme për integrim në BE: Sundimi i ligjit, qeverisja ekonomike dhe reformat administrative. BE ka filluar negociatat për anëtarësim me Serbinë dhe Malin e Zi, ndërsa shtetet kandidatë që presin hapjen e negociatave janë Maqedonia Veriore dhe Shqipëria. Sa i përket sundimit të ligjit, Zwaenepoel tha, se tani çështja më e rëndësishme do të jetë rezultati i gjykimeve që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe sundimin e ligjit. "Ne i kemi kushtuar vlerësi rezultateve" në vlerësimin që do t'u bëhet shteteve në procesin e negociatave. Duke shpjeguar këtë Zwaenepoel tha, se BE-ja ka vendosur sisteme monitorimi të gjykatave. Ajo shtoi se BE është në negociata me OSBE në që të vendosin një mekanizëm për monitorimin e proceseve gjyqësore që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e



organizuar. Përveç kësaj BE-ja ka aplikuar edhe mekanizma të ndërprerjes së negociatave, suspendimit të tyre, apo futjes së kushteve të reja gjatë procesit negociativ. Të gjitha këto do ta bëjnë procesin e anëtarësimit në BE për shtetet e reja më të komplikuar, por duke forcuar punën për sundimin e ligjit. Ky debat bëhet ndërkohë që BE-ja është duke u përballur vet me probleme në sundimin e ligjit nga vendet anëtare. Shkeljet të rregullave të BE-së ka bërë Hungaria me ligjin e OJQ-ve sidomos me pjesën ku ndalohej financimi i tyre nga jashtë. Gjithashtu Zwaenepoel, përmendi që Gjykata Evropiane e Drejtësisë është duke u ngarkuar me raste të reja duke i referuar situatës në Poloni ku pavarësia e sistemit gjyqësor është

ë të kërcënuar. Ekspertja nga BE-ja, gjithashtu, theksoi se në raste kur buxheti i BE-së është i kërcënuar nga keqmenaxhimi do të ketë mekanizma për ndërprerjen e fondeve si për anëtarë aktualë të BE-së ashtu edhe për ata të cilët aspirojnë unionin. Në kuadër të mekanizmave nxitëse për zbatimin e reformave, Zwaenepoel përmendi liberalizimin e vizave. Në këtë çështje reagoi hulumtuesja Tena Prelec duke thënë se BE-ja duhet ta mbajë fjalën, sepse ndryshe humb kredibilitetin, siç ka ndodhur me rastin e Kosovës. Tena Prelec nga Universiteti London School of Economics prezantoi një raport të bërë nga një grup i hulumtuesve për Ballkanin të quajtur BiEPAG. Raporti i jep rekomandime BE-së se çka duhet bërë në mënyrë

që sundimi i ligjit të përmirësohet dhe kjo të bëhet në formë të qëndrueshme në mënyrë që të mos ketë prapaktheu, kur hiqen kushtëzimet e BE-së. Në raport sa i përket korrupsionit në Ballkanin thuhet se ai është "i veçantë" në formën që shoqëritë e Ballkanit janë të karakterizuara me shpërndarje të vazhdueshme të të mirave publike në baza jo universale, që pasqyrojnë shpërndarjen e padrejtë të pushtetit në këto shoqëri. Pra që korrupsioni është më shumë rregull se sa përrjashtim. Në raport, gjithashtu, thuhet se BE ka

bërë kushtëzime për vendet e Ballkanit Perëndimor, mirëpo përkundër kësaj "ndikimi mbetet i kufizuar. Në vend që të forcohen institucionet, demokracia është në tërheqje në Ballkanin Perëndimor". Në kuadër të masave të parashikuara në këtë raport përfshihet dhënia e "masave korrektuese në mënyrë më të shpejtë dhe më të fuqishme si dhe veprime të tjera që kanë të bëjnë me raportim më të shpejtë dhe më të shpeshtë. Aty, gjithashtu, rekomandohet që "prioritetet të pasohen nga nisma pozitive dhe masa sanksionuese".

Hetonte korrupsionin, atentat gazetarit investigativ

Në kryeqytetin Accra të Ghanës, një gazetari investigativ që ka hetuar korrupsionin në ligat e futbollit, teksa udhëtonte me makinë drejt banesës së tij. Ahmed Hussein-Suale u qëllua tre herë nga disa persona me motor. Vrasja e gazetarit vjen në një kohë kur vija e politikës kishte bërë thirrje për ndëshkimin e tij. Hetimet e gazetarit investigativ për korrupsionin në futboll çuan në ndalimin e përjetshëm në aktivitetet sportive të ish-Presidentit të Futbollit të Ghanës. Autoritetet lokale thanë se gazetari u qëllua dy herë në gjok dhe një herë në qafë. Ahmed Hussein-Suale kishte bashkëpunuar disa herë edhe me BBC për disa çështje të ndryshme, duke përfshirë edhe një hetim për shtjetjen e organeve apo të pjesëve të trupit. Në bazë të statistikave, dhuna ndaj shtypit është një fenomen i rrallë në Ghanë. Sipas Komitetit të Mbrojtjes së Gazetarëve, vetëm një gazetari është vrarë në Ghanë në vitin 1992. Kurse Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve thotë se 8 gazetarë u vranë në të gjithë Afrikën në vitin 2017.



Media ruse: Zyrtares multilioner pretendon se ka vetëm një shtëpi

Prokuroria e Përgjithshme ruse deklaroi se një zyrtar rajonal në Moskë, i cili po hetohet për shpërdorim detyre, në të vërtetë është një multilioner. Sipas asaj që shkruan e përditshmja "Russia Today", Prokuroria pritet që të kërkojë sekuestrimin dhe konfiskimin e pronave të Aleksander Shestun, që përllogaritet se vlejné rreth 150 milionë dollarë. Sipas organit të akuzës, pasturia e tij, e përfituar nëpërmjet një rrjeti kompleks mashtrimesh dhe ndërmjetësish, përfshin 565 parcela tokë, 111 shtëpi dhe apartamente, si dhe 22 makina. Ligji antikorrupsion rus e lejon sekuestrimin e pasurive të zyrtarëve, të cilët nuk mund të vërtetojnë se janë pronarët e ligjshëm. Nëse konfirmohet dhe autorizohet nga një gjykatë, Shestun do të thyente rekordin në termat e sasisë së pasurive të konfiskuara. Rekord aktual, sipas të përditshmes ruse, mbahet nga Dmitry Zakharchenko, një ish-zyrtar i Ministrisë së Brendshme, familjes të të cilit vitin e shkuar iu sekuestruan pasuri me vlerë plot 125 milionë dollarë, pasi nuk justifikoi dot origjinën e tyre. Avokatët e Shestun i mohuan pretendime e prokurorisë dhe u shprehën se vetë zyrtari u surprizua kur mësoi se ishte multilioner. Ata thanë se klienti i tyre ka në pronësi vetëm një shtëpi, një makinë dhe një llogari bankare me vlerë 15 mijë dollarë. Zyrtari kishte mbajtur në të shkuarën detyrën e kreut të një prej bashkive rajonale të Moskës. Vitin e shkuar ai u arrestua dhe u akuzua për abuzim me detyrën dhe shpërdorim të pronave të bashkisë. Pak kohë përpara arrestimit të tij, Shetun publikoi disa video ku i kërkonte mbrojtje Presidentit rus Vladimir Putin, duke pretenduar se kërcënohej nga zyrtarë të tjerë rusë. Ai tha se e gjithë çështja kundër tij ishte e stisur, në mënyrë që të mos rikandidonte.

EKSPOZITA



Fatmira Nikolli

MAKS VELO: Fshati primitiv ndriçohet nga meteorë

30 vepra të krijuara gjatë vitit të fundit dhe disa nudo të mëhershme janë ekspozuar dhe në mbrëmje në galerinë e Arteve FAB. Maks Velo rikthehet me një ekspozitë duke u prezantuar me vepra në akrilik, teknikë e njohur për të. "Fshati primitiv ndriçohet nga meteorë" është titulli i ekspozitës personale për vitin e ri 2019, që sapo hyri, i artistit-piktor Maks Velo. Një emër i njohur për publikun si arkitekt, piktor e aktivist aktiv. Kuratori Mikel Temo thotë se tashmë në të 80-at, ai vazhdon të angazhohet e krijon imazhe të një karakteri të veçantë, reminiscenca të një të kaluarë të rëndë persekucioni që pa dyshim ndërthuren e ndriçohen nga ndryshimi dhe e sotmja. Galeria e Fakultetit të Arteve të Bukura njoftoi më herët se ekspozita ofron një spektakël koloristik, një ngjarje kreative për personalitetin e autorit, të cilit, ashtu siç thotë dhe vetë ai, "tashmë; ëndrra, imagjinata, fantazia dhe shfaqja njerëzore vijnë me ngjyra". Kuratori Temo vë në dukje se u desh kohë që e zeza, makthi, persekucioni, të zbehën e vendin e tyre ta përfshijë një botë plot ngjyra e jetë. A do ta zëvendësojë ajo errësirën...? Kjo mbetet për t'u zbuluar. Procesi ka filluar, krijimi vazhdon...

"Në fillim Velo operon me pastele si një shtresë e parë mbi të cilën mbivendos akrilikun; aty ku transparenca mes pastelit dhe akrilikut mbivendosen japin një pasuri", tha dje Temo për "GSH".

I pyetur për titullin kuratori tha se "Fshati primitiv ndriçohet nga meteorë- nënkupton që gjithë Shqipëria në situatën që është dhe me problemet që kemi, është një fshat primitiv, për nga mënyra e mendimit, e të jetuarit dhe të vepruarit. Ndriçimi me meteorë është simbolikë. Është shpirti pjesë e ndriçimit të veprës dhe bëhet loja mes të kaluarës si persekucion dhe burg dhe të sotmes që është kjo dritë e liri. Nëse dikur artisti ndriçohet në burg përmes dritares së qelisë, sot ndriçohet në hapësirë. Autori jep këshut energjinë e duhur, për procesin krijues", tha dje Temo.

Ekspozita personale e piktorit të njohur Maks Velo mund të vizitohet deri me 30 janar 2019.

Artisti Maks Velo përfaqëson një figurë komplekse të një intelektual, arkitekti, piktori, studiuesi, analisti, publicisti dhe shkrimtari. Ai ka patur një jetë mjaft të vështirë pasi në artin e tij të viteve 1960-1978, pasqyro ndikimin e artit modern dhe post-

modern evropian duke u cilësuar si dekadent dhe armik i partisë dhe shtetit komunist. Për krijimtarinë e tij artistike Velo u kritikua rëndë dhe u dënua me burg në minierat e kampit të Spaçit, jetë të cilën e përshkruan më vonë pas viteve 1990 në botimet e tij të ndryshme memorial & publicistike.

Maks Velo lindi në Paris (Francë), në familjen e doktor Sotirit, i cili kishte mbaruar studimet për mjekësi të përgjithshme në Athinë, (Greqi) dhe ishte specializuar për okulistikë në Francë. Nëna Ani Poro, ishte e bija e një emigranti nga fshati Dardhë (Korçë) me shtetësi amerikane. Familja Velo kthehet në Korçë, Shqipëri (1939) dhe Velo i ri kreu mësimet deri në vitin e dytë në gjimnazin "Raqi Qirinxhi", duke qenë nxënës i piktorit Vangush Mio. Figura e Velos është shumëplanëshe dhe mjaft e veçantë. Ai qe një fëmijë mjaft inteligjent e kurioz. Që në moshë të re përveçse vizatonte mjaft bukur, i binte pianos, lexonte në disa gjuhë të huaja (frëngjisht, italisht, rusisht etj.) dhe ëndërronte të bëhej arkitekt. Pasi familja e tij në vitet '50 transferohet me banim në Tiranë, Velo i mbaroi dy vitet e fundit të shkollës së mesme në gjimnazin "Qemal Stafa" (1952) e më tej ndjek studimet e larta në degën e inxhinierisë së ndërtimit - arkitekturës. Pas diplomimit caktohet si arkitekt në byronë e projektimit të Komitetit Ekzekutiv të Kryeqytetit. Është autor i mjaft ndërtesave publike, shoqërore e kulturorë. Në këto vite pasionoi për pikurën dhe veçanërisht për vizatimin e tërheq dhe ai ka një krijimtari të pasur, gjë që e shtyn Velon të dalë para publikut të kryeqytetit me ekspozitat e tij të para vetjake (1958, Durrës); dy ekspozita në Tiranë (1959 - 1961). Në vitin 1960 ai do të marrë pjesë në Ekspozitën e Artit Shqiptar që çelët në Erevan, Moskë dhe Bukuresht. Krahas artistëve të



Ekspozita në galerinë FAB, nudo dhe punimet e vitit të fundit



formuar në Akademitë e Lindjes në ekspozitat dhe Konkursit Kombëtare të Arteve Figurative në vitet 1968-1972, Velo ishte prezent në pesë prej tyre. Që kur studioi për inxhinieri ndërtimi - arkitekturë, Velo ishte i prirur të



vrojonte e më pas të studioi me mjaft vëmendje krijimtarinë artistike të krijuar në shekuj nga mjeshtërit popullorë anonimë si: figura e Skënderbeut, maskat, gurët e varreve, figurat në dyll të ngjyrosura për pashkët, trokitëset metalike të dverve, forma e shqiponjës dykrenore, kërraba të gëhdurura të barinjve etj. Pleoniumi i 4-të i KQPPSH e kritikoi Velon si mbartës i ndikimeve të huaja më krijimtarinë e tij artis-

tike dhe nga shtatori 1973 deri më 1978, ai transferohet me punë në fshatin Ndroq, 15 km larg Tiranës si masë dënuese nga ana e shtetit komunist të Enver Hoxhës. Më 14 tetor 1978, arrestohet dhe dënohet me 10 vjet burg politik (lirohët në vitin 1986 dy vjet para mbushjes së dënimit të plotë nga ligji i amnistisë). Pas daljes nga burgu kthehet në Tiranë dhe punon si punëtor i thjeshtë në Uzinën e gurëve abrazivë (1978-1991). Maks Velo merr statusin e të burgosurit politik dhe më 1992 bëhet shtetas amerikan... Krijimtaria e Velos / piktor ndahet në dy periudha: atë nga fillimet deri në vitet 1978 (kur i sekuestrohen dhe digjen nga policia me vendim Gjykatë 468 vepra të ndryshme arti) dhe periudhën nga vitet '90 e në vazhdim ku "regjistrohen" mbi 40 ekspozita vetjake. Periudha e parë fatkeqësisht nuk njihet për shkak të eliminimit fizik të veprave të cilësua nga pashteti komunist i kohës si "dekadente", "me ndikime të artit perëndimor", vepra të cilat u bënë dhe aktakuza kryesore e dënimit të Velos me 10 vjet heqje lirie. Nga ky koleksion kanë shpëtuar vetëm 35 vepra që u dërguan fshehurazi në Paris dhe ju kthyen autorit pas viteve '90. Një njohje mbi këtë veprimtari pjesërisht mund të merret edhe me anë të cikleve të vizatimeve që Velo publikonte në revistën periodike të kohës "Shqipëria e Re". Këto vizatime mund të vlerësohen veçanërisht për linjën e shkathët, stilizimin e figurave, kompozimin jo të zakonshëm dhe jashtë skemave e kanoneve të artit të realizmit socialist. Ato ishin vizatime më moderne të kohës të publikuara në Shqipëri. Në periudhën e dytë piktori Velo ka realizuar disa cikle piktorikë që titullohen: druvaret; leberit; instrumentistë popullorë, njeriu dhe trau duke realizuar në një hark kohor rreth 17 vjeçar, dhe të paraqitura në mbi 40 ekspozita vetjake, shumica e të cilave jashtë Shqipërisë.

RRËFIMI

BARDHA MELYSHI: 7 vjeçe në kamp internimi

Historitë e rralla të koleksionit të dëshmvive "Edhe muret kanë veshë" (Remembrance to Heal and Prevent), mbledhur dhe përshkruar me në gjuhën angleze nga gazetaria shqiptaro-amerikane Kristalë Ivezaj Rama tani mund të gjenden edhe online.

Projekti i realizuar nën kujdesin e Autoritetit për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të shtetit u ofroi mundësi shumë njerëzve të sillnin dëshmitë dhe përjetimet e tyre personale në vitet e regjimit komunist, duke bërë që edhe të rinjtë të njohin një pjesë të historisë më të errët të vendit tonë.

"Jemi për të mbledhur meazhet e pathëna që kanë mbetur gjatë diktaturës, përjetime, vuarjet, shija e kurajës dhe e solidaritetit. Është një projekt i Autoritetit, që bashkë me dosjet, që janë përgjithësisht instrumente të shtypjes dhe denigrimit të personave të rëndësishëm të shoqërisë sonë të asaj kohe, dhe dëshmvive gojore, ta themi historinë në 360 gradë. Pra, për të thënë atë që është shkruar, por edhe për atë që është përjetuar në atë kohë"- shprehej Kryetarja e Autoritetit, Gentiana Sula.

Artistja Alketa Xhafa Mripa theksoi se kjo nismë, përmes artit dhe historisë, kërkon të provokojë mbi të shkruarën.

"Për këtë veprë kemi takuar dhe biseduar me mbi 60 persona të dënuar politikë dhe të përdjekur politikë. Tekstet janë rrëfimet e tyre të singerta. Unë jam shqiptare e Kosovës, edhe atje muret kanë pasë veshë, por atje krimet i kryen armiqtë serbë, ndërsa këtu në Shqipëri është e pabesueshme se çfarë krimesh kanë kryer komunistët shqiptarë mbi shqiptarët e thjeshtë. Shumë nga të dënuarit që takuam po presin vetëm një kërkim falje e ndjese nga persekutorët. Shqiptarët e kanë në fisnikërinë e tyre historike edhe kërkimin e faljes edhe me falë, dhe ndjese duhet të kryhet, edhe pse me kaq vonësë" - qe shprehur atë kohë artistja Alketa Xhafa Mripa.

RRËFIMI I MELYSHIT
Vetëm 7 vjeçe, Bardha Melyshi u dërgua në kampin famëkeq të Tepelenës, nga ku pak dolën gjallë, bashkë me të ëmën dhe 2 motrat. Në të njëjtën kohë, familja e saj ishte përçarë, me 35 njerëz të dërguar nëpër kampe të ndryshme rreth e përqark vendit. Shumë nga pjesëtarët e saj të familjes ishin djegur të gjallë kur oficerët e Sigurimit të Shtetit dogjën shtëpitë e tyre në Rrëshen.

Fëmijëria dhe adoleshenca e Bardhës në Tepelenë ishte e mbushur me kushte sanitare të pabesueshme, uri, mbipopullim dhe nevojja bazike non-ekzistente.

Rrëfimi i gruas që u rrit në internim në "Edhe muret kanë veshë"



Bardha Melushi lindi në 5 gusht 1939 në Kthellë të Mirditës. Ajo është 79 vjeçe dhe jeton në Shkodër me babain e saj.

Qindra fëmijë vdiqën në këtë kamp, i pushtuar nga sëmundjet. Disa trupa janë varrosur në varre pa emër, disa të tjerë janë hedhur në lumin Bëncë, që t'i merrte lumi me vete. Vendndodhja e shumicës së trupave nuk dihet.

Kampi mbahet mend nga mbijetuesit si një kamp skllavërie, ku të internuarit lihehin të uritur dhe në mëshirën e sëmundjeve të ndryshme, të cilat vinin nga ushqimi i keq dhe mungesa e higjienës. Racionet e ushqimit



ishin planifikuar në limitin e mbijetesës.

Bardha ishte 20 vjeçe kur u lirua. Tashmë 79 vjeçe, historitë e saj janë kaq pikëluese, sa edhe nipat dhe mbesat e saj dhe familjarë të tjerë, e kanë të vështirë ta besojnë që kanë genë të vërteta; kështu që ajo flet për ato shumë rrallë. Ajo thotë se i ka thënë gjithmonë vetes që "edhe muret kanë veshë", kështu që ka qëndruar e heshtur - deri tani.

Fjalët e saj:
Ky vend për ne ishte si një burg, në të cilin dënoheshim ilegalisht dhe pa gjykatë.

Ishim nën urdhrat direkte të dikujt tjetër, as nuk guxonim të merrnim frymë. Duhet të mblidheshim për apel 3 herë në ditë dhe na jepnin 300 gram bukë për të gjithë ditën. Ky ishte një kamp shfarosjeje, jo kamp internimi.

Isha 7 vjeçe kur hyra në kampin e Tepelenës dhe isha 20 vjeçe kur u lirova.

Ditën që u liruar nga kampi, mamaja ime ra në gjuhë dhe tha: "Oh Zot i madh çfarë të mire më ke bërë. Hyra në kamp me 3 vajza e mia dhe po dal me të tria!" Kishte nëna që kishin hyrë me 5 fëmijë dhe dolën pa asnjë, pasi shumë vdiqën gjatë epidemisë.

Ishte një herë gjatë qëndrimit tim në kamp kur fjeta dhe u zgjova me një dhimbje të madhe fyti. Isha në gjendje të rëndë për 3 ditë.

Isha me fat, sepse kishte njerëz që i kishte ndodhur kjo dhe kishin vdekur në kamp dhe asnjë nuk kishte treguar ndonjë interes për t'i ndihmuar.

Di që trupat e vdekur i varrosnin pranë kodrës dhe më vonë i zhvarrosën dhe i dërguan diku tjetër pranë lumit. Por kodrën e

mbaj mend shumë mirë.

Në kamp flinin në rreshta; kishte një oficer policie të armatosur, i cili ecte para-mbrapa me një elektrik dore, që të sigurohej që të gjithë ishin në vendet e tyre gjatë natës; në qoftë se nuk ishin, na dënonin.

Mbaj mend që kur dërgonin 3 vajza më të mëdha se unë për të mbledhur dru zjarri, i shoqëron të gjithmonë një polic. Ne nuk na duhej druri, sepse nuk kishim një oxhak ku mund të ngroheshim. Vajzat e mblodhën drurin dhe e lidhën me litar. Gjatë rrugës së kthimit, duhet të kalonin në një kodër dhe druri i ra gabimisht. Ushtari i bëri të vraponin që të merrnin drurin që kishte rënë në fund të kodrës, ta çonin lart, dhe pastaj ia hodhi përsëri. Mbas shkuan ta merrnin drurin dhe u ngjiten prapë lart, u dënuan për 24 orë pa bukë.

Një rast tjetër që mbaj mend, është rasti i djalit të xhaxhait tim Simonit. E pyeti mamanë nëse mund t'i jepte një palë çorape leshi, në mënyrë që t'i këmbente me miell misri. Ai u kthye në kamp mbas orarit të lejuar dhe tentoi të futej brenda fshehurazi. Një oficer e pa me miell në dorë. Ja hodhi miellin në tokë dhe e lidhi përballë hyrjes së kampit për 24 orë. Ne na dhimbsej shpirti për të, por nuk kishim se si ta ndihmonim.

Por sot, unë jam kush jam, sepse kam punuar natë e ditë dhe e kam mbajtur gojënj mbyllur. I thosha vetes që edhe muret po më dëgjonin. Jam e lumtur që ka ardhur demokracia.

Deri dhe kisha një lepër në bark, ndërsa sot kam një qen. Flas sa më shumë që mundem, sepse të paktën sot nuk ka asnjë që mund të më lëndojë.

LAMTUMIRË RAPSDIT TOM NIKOLLA

Është ndarë nga jeta në moshën 92 vjeçare, rapsodi popullor, mjeshtri i çiftelisë Tom Nikolla. Tom Nikolla u lind në fshatin Iballë të Pukës në vitin 1927 në një familje me tradita. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa atë të mesme në Shkodër. Ai filloi të aktivizohej si artist dhe organizator në grupet artistike amatore të Pukës dhe më vonë të Shkodrës, të cilat i hapën rrugën e njohjes dhe të suksesit në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Krijimi i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore në vitin 1957 përfshin krahas shumë artistëve më të njohur të vendit edhe rapsodin popullor Tom Nikolla. Po në këtë vit

mori pjesë në "Festivalin e Rinisë" në Moskë dhe u nderua me "Medalje të Artë", medalja e parë e artë që merr një artist shqiptar në një aktivitet ndërkombëtar. Që nga ky vit fillon aktiviteti i mirëfilltë artistik, që në vitet në vijim do të njihet dhe më shumë. Në vitin 1964 mori pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Egjiptit ku u dekorua me "Medalje të Argjendtë". Gjatë aktivitetit të tij artistik perfeksionoi mjeshtërinë e tij artistike në disa drejtime si instrumentist në çifteli dhe fyell, por edhe si këngëtar dhe krijues tekstesh, duke i përshtatur meloditë. Ai u kthye në një figurë mjaft të njohur në llojin e gjinisë muzikore që përcolli tek publiku i gjerë. Repertori i rapsodit ka qenë mjaft i gjerë dhe tepër i larmishëm. Deri në vitin 1975 ka punu



ar në Ansambllin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore si rapsod popullor, krahas mjeshtrove si: Luçie Miloti, Fitnete Rexha, Naile Hoxha, Ibrahim Tukiçi, Xhevdet Hafizi. Në 1975 filloi punë në Ansambllin e Tekstileve në Tiranë dhe në vitin 1988 ai doli në pension. Edhe pas daljes së tij në pension, rapsodi nuk e ndërpreu aktivitetin e tij artistik. Tom Nikolla mbetet personifikimi i çiftelisë dhe rapsodive popullore ashtu siç është titulluar libri monografik "Çifteli dhe këngë". Në shtator të vitit 2000, rapsodi Tom Nikolla u dekorua me urdhrin "Naim Frashëri i Argjendtë" dhe në qershor të vitit 2006, Bashkia e Pukës e nderoi me titullin "Krenaria e Qytetit".

Zhvillimet e teknologjisë digjitale në arsim

Nga Pëllumb Karameta

(Vijon nga faqja 1)

... dhe, së fundmi, arsimit masiv. Me fjalë të tjera, nismen nga hipoteza se po i afrohem revolucionit të katërt me përmasa të ngjashme". Kështu e portretizoi, në fillimin e këtij shekulli, ndryshimin që po ndodhte në sistemet e edukimit në botë, një prej mendjeve më të ndritura të shkencave psikologjike, J. Bryner. Ndryshim që zhvendosi në praktikën pedagogjike theksin nga mësimdhënia që synonte memorizimin e përmblajtjeve lëndore, të nxënësve e vazhduar gjatë gjithë jetës. Nxënie që e aftëson subjektin të dijë, të dijë të bëjë si duhet dhe të shpjegojë përse e bëri ashtu. Qasjet e reja pedagogjike, të bazuara kryesisht në teorinë konstruktivistike, vunë theksin tek aktiviteti i individit i cili, përmes veprimtarisë së tij, arrin të ndërtojë dhe zbatojë gjithë sa mëson, në institucionet arsimore apo jashtë tyre. Është kjo teori, ajo që mundësoi integrimin e teknologjisë digjitale në arsim dhe i hapi rrugën ndërtimit të kompetencës digjitale, një nga elementët kyç të identitetit bashkëkohor të rinisë. Ajo i referohet kapacitetit që personi ndërton sistematikisht dhe i mundëson të përdorë teknologjinë në shtëpi, shkollë ose punë. Kompetenca integron shkathhtësi kyçe me të cilat subjekti përdor teknologjinë për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar, shkëmbyer informacion dhe bashkëpunuar në internet. Në këtë kontekst, në dy dekadat e fundit, në sistemin tonë arsimor ka zhvillime dhe po përballen sfida.

1) Zhvillimi i parë lidhet me përpjekje për të dizajnuar programe kompjuterike për menaxhimin e arsimit. Në vitet 1998-1999, Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Fondacionin "Soros", mbështetën zbatimin e programit "School mapping database", për të identifikuar në mënyrë elektronike rrjetin e shkollave dhe orientuar politikën për rajonizimi / rigrupimi e shkollave në vend. Edhe pse nuk u sigurua produkt i synuar, mund të themi se programi përbën rastin e parë të përdorimit të teknologjisë digjitale për administrimin e arsimit. Në këtë linjë, ndër vite, ndërmerren nisma për hartimin e standardeve të teknologjive në arsim, për ndërtimin e laboratorëve të informatikës, së bibliotekave digjitale, për infrastrukturën e TIK-ut në shkollë, për trajnimin e mësuesve të teknologjisë, për shortin digjital të administrimit të provimeve etj. I tillë është, p.sh., projekti



"Sokrates" që pritet të mundësojë funksionalitetet për kërkim, menaxhimin, planifikimin e vlerësimit të sistemit, në të gjitha nivelet e tij.

2) Zhvillimi i dytë identifikohet me nismat për të pajisur shkollat me pajisje digjitale si kompjuter, laptop, video-projektor, tabela inteligjente (smartboard), tablete, si dhe për të lidhur mjediset shkollore me Internetin. Sot kemi rreth 1500 laboratorë kompjuterësh. Rrjeti i internetit është instaluar në shkollë dhe rreth 1100 syresh kanë lidhje të dedikuara në mjediset e laboratorëve kompjuterike me shërbim të ofruar në parametrat 2-10Mb/sec. Ndërkohë, afro 800 shkollë furnizohen nga PAP me një shpejtësi 8Mb/sec. Këtu përfshihet, p.sh., projekti për digjitalizimin e nxënies me tableta. Një lloj kompjuteri vetjak i lëvizshëm ky, me madhësinë e librit të zakonshëm (diagonalja e tij rritet, duke filluar nga 18 cm.), që funksionon përmes prekjes së ekranit, në mjedisë ku mundësohet komunikimi wireless (pa përcjellës elektrik). Në kontekstin pedagogjik,

tableta është pajisje që u mundëson nxënësve: a) shndërrimin e dijeve të kodifikuara në programet dhe tekstet në njohuri të reja vetjake, përmes kërkimit në situata që u kuptojnë domethëniet; b) zhvillimin e mënyrave me të cilat krijohen dhe komunikohen kuptimet në botën e sotme (imazhet, fjalët e shkruara ose pamjet vizuale, grafikët, tingujt, informacionin digjital ose mediatic); c) lidhjet dhe ndërveprimet mes sistemeve të ndryshme të dijes dhe mënyrave të paraqitjes së njohurive që ndërtohen prej tyre; d) dallimet në procesin mësimor, duke mënjeluar qasjet që i përgatitin të gjithë "me një kuti"; e) zhvillimin e proceseve mendore, bazë për trajtimin e situatave jetësore, jo thjesht produktet (sistemet e ngurta të dijeve lëndore). Përdorimi i tabletës mundëson gradualisht dizajnimin e teksteve digjitale në shkollë, si mjete me të cilat nxënësit mund të mësojnë përmblajtjet e përshtatura për aftësitë dhe interesat e tyre. Tekstet digjitale "jetojnë dhe ndryshojnë" sistematikisht dhe u lejojnë nxënësve të krijojnë njohuri për vetë dhe komunitetin.

3) Zhvillimi i tretë shprehet përmes përpjekjeve për familjarizimin e personelit pedagogjik me teknologjinë digjitale. Fillimisht, në fokus kanë qenë mësuesit që zhvillojnë lëndët e TIK-ut të cilët, përveç teksteve të digjitalizuara, kanë dhe një platformë online në shqip, të dedikuara për ta. Ndërsa aftësimi i mësuesve të tjerë, për përdorimin efikas të pajisjeve teknologjike në procesin mësimor, me gjithë përpjekjet vetjake apo institucionale, mbetet sfida që duhet tejkaluar.

4) Integrimi i teknologjisë digjitale drejtpërdrejt në procesin e nxënies. Në terma të përgjithshme, ky zhvillim përfshin dy aspekte themelore. I pari ka të bëjë me ndryshimet që mundësoi reforma kurrikulare. Tani e në vijim, elementet e teknologjisë, në funksion të ndërtimit të kompetencës digjitale, janë përfshirë në kurrikulin e arsimit parauniversitar.

Aspekti i dytë lidhet: a) me dizajnimin e produkteve digjitale që mund të përdoren drejtpërdrejt në procesin mësimor-edukativ; b) me aftësimin e mësuesve për ta përdorur teknologjinë në praktikën pedagogjike. Integrimin e këtyre elementeve e mundëson platforma digjitale "School Me". Ajo është përgatitur nga specialistë të teknologjive të informacionit, akademikë, mësues, profesionistë britanikë dhe ndërkombëtarë, të formuar në Oxford, Cambridge dhe University of London. Për nevojat e kurrikulave të reja, që po zbatohen në Shqipëri dhe Kosovë, platforma është zhvilluar nga studentë të talentuar shqiptarë dhe evropianë, të profileve shkencore, të ndi-

hmuar nga mësues shqiptarë me eksperiencë. Ajo drejtohet dhe menaxhohet nga Thames Online Education, një kompani me qendër në Londër. Platforma e mbështetur nga MASR dhe OSFA, po pilotohet në 35 shkollë të qarqeve Tiranë, Elbasan, Lezhë dhe u ofrohet 1200 mësuesve dhe rreth 15000 nxënësve.

Platforma shtjellon të gjitha mësimet, në formë videosh, për lëndët kryesore në arsimin bazë. Mësimet janë zhvilluar nga mësues me eksperiencë. Dijet lëndore paraqiten në formë vizuale dhe kuptimi i tyre lehtësohet nga filma shkencorë, harta, dokumente historike, eksperiencën e laboratorit dhe teste online. Mësimet janë renditur në përputhje me programet mësimore dhe aksesohen menjëherë. Kapacitetet e platformës do të shfrytëzohen nga mësuesit në orën e mësim-it, për të ndihmuar konkretizimin dhe kuptimin nga nxënësit. Hyrja në platformë është e lehtë, përmes kodit personal të mësuesit ose të nxënësit. Shkollat pilot janë pajisur me internet për qasje të menjëhershme në platformë. Çdo nxënësi i është krijuar profili personal për përdorimin e platformës në shtëpi, përmes kompjuterit, tabletës ose celularit. Një komponent i rëndësishëm i pilotimit është aftësimi i mësuesve për të përdorur teknologjinë digjitale në procesin e të nxënësve, përmes 4 moduleve të akredituar nga MASR.

Veçmas vlerave të mirëfillta mësimore - edukative, kjo risi teknologjike konsiderohet përvoja e parë e zbatimit të teknologjisë digjitale drejtpërdrejt në procesin e nxënies. Nga ana tjetër, lehtësia për t'u përdorur kudo, kurdoherë, nga kushtojt (mësues, nxënësi, prind) mundëson që, pjesë të rëndësishme të dijeve lëndore, të mund të arrihen nga të gjithë. Ndaj, platforma "School Me" vlerësohet si investimi që sfidon ndarjen digjitale të nxënësve e cila, nëse nuk adresohet me përparësi, do të sjellë ndarjen e tyre në formim.

Në sintezë, edhe pse për sistemin tonë, prurjet e revolucionit digjital në arsim, mund të duken objektiva të një formati të madh dhe sfidat të vështira për t'u përballur, së pari, të nisim të kuptojmë si duhet ta konceptojmë shkollën digjitale, përse ajo duhet konceptuar e tilla, si t'i mendojmë nevojat e nxënësve, si ta dimë kur jemi të suksesshëm etj. Sepse shkollat e reformuara projektohen, jo për të mbushur kokat e nxënësve me lloje të veganta të dijeve ekzistuese, por për të rritur kompetencat e tyre, së pari, për të nxënë vetë dhe për të ndërthurur, prodhuar dhe zbatuar njohuri të reja.

Tiranë, më 16/01/2019

Zhvillimi i parë lidhet me përpjekje për të dizajnuar programe kompjuterike për menaxhimin e arsimit. Në vitet 1998-1999, Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Fondacionin "Soros", mbështetën zbatimin e programit "School mapping database", për të identifikuar në mënyrë elektronike rrjetin e shkollave dhe orientuar politikën për rajonizimi / rigrupimi e shkollave në vend.

Opinioni *i* Ditës

Mirë protesta, por cili është fundi?

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... deri në rrëzimin e Edi Ramës. Basha dhe Kryemadhi u shfaqën dje të irrituar pas daljes nga Kuvendi dhe trumbetuan marshimin pa kthim pas, sikur ky të kishte qenë fundi i fjalës së lirë në Shqipëri dhe shkelja më e madhe e qeverisë mëkatore të Rilindjes.

Por, pavarësisht nga irritimi i tyre grotesk, askush nuk e mohoi se sot ka 1001 arsye për të dalë në rrugë kundër kësaj qeverie.

Sot mund të protestosh për rrëzimin e kryeministrit të të pasurve, që pasi u shpërndan atyre para me letra false, u përgjysmon në fund edhe tatimin mbi dividendin.

Sot mund të protestosh kundër kryeministrit që është i gatshëm të prishë dyqind shtëpi dhe të devijojë Lanën, vetëm për t'i hapur fushë ndërtimi një klienti të tij trafikant.

Sot mund të protestosh kundër kryeministrit që është i gatshëm t'i lërë studentët të ngujuar në auditorë, vetëm që mos pranojë se reforma e tij në arsim rezultoi një dështim.

Sot mund të protestosh kundër kryeministrit, administratës të të cilit i ranë pantallonat në tokë përpara Klement Balilit.

Sot mund të protestosh kundër kryeministrit, që nuk u ngop me gazetaret vendas, por filloi të quajë edhe ata të VOA kazan.

Sot mund të protestosh kundër kryeministrit që po i ofron shqiptarëve një kabinet me fytyra të pavotuara, njësoj sikur po përzgjedh baqevanët e shtëpisë së tij në Surrel.

Por, sado të drejta të jenë arsyet e mësipërme dhe shumë e shumë të tjera që përlligjin daljen në rrugë kundër Edi Ramës, në fund ato përmblidhen përpara një pyetje fatale: cili është qëllimi?

Sipas asaj që kumtuuan Basha dhe Kryemadhi, ai është rrëzimi i kryeministrit nga froni.

Po a rrëzohet ai me protesta paqësore?

A është e mundshme perspektiva që përsërit në mënyrë kompleksive kreu i PD-së, se ai "nuk do një pushtet që kapërcen mbi kufoma", por një rotacion që vjen



përmes votës?

A është e mundshme mpostja me votë e kryeministrit të të pasurve, i cili tashmë kontrollon miliardat që ndan me oligarkët e vet, ka sofistikuar lidhjet me krimin, ka futur në dorë drejtësinë, shërbimin sekret dhe i fsheh të gjitha këto përmes kapjes të të gjithë pronarëve të mediave të mëdha?

A është e mundur për shembull që dikush të imagjinojë një fitore të koalicionit opozitar në Tiranë, ka falë lidhjeve okulte me çiftin Rama- Veliaj po investohen miliardat pa origjinë në ndërtim dhe ku të gjithë ata që kanë hedhur paratë do të financojnë vazhdimin e këtij binomi?

Pra, iluzioni se e keqja e Rilindjes zgjidhet me rotacion dhe jo me përmbyse, është një shaka që nuk e beson më askush.

PD dhe LSI, nëse do t'i kishin të

vërteta përбетimet e tyre, nuk do ta kërkonin zgjidhjen me sharje dhe bërtitje poshtë zyrës së Ramës. Zgjidhja e tyre e vetme do të ishte beteja me tërë sistemin që ka ngritur ai.

Dhe në këtë pikë ata e humbën një mundësi të artë. Ata patën frikë të djegin mandatet, pagat, dietat dhe celularët që u siguron karrigia e tyre në Kuvend.

Ata tani kanë edhe një sfidë tjetër: të mos joshen nga gara farsë e qershorit ku duan t'i tërheqin si cjamin të kasapi. Ata duhet të dinë t'i thonë jo tundimit për disa tenderë ujësjellësish, për disa të punësuar më shumë nëpër bashki dytësore, apo për ruajtjen e disa bastioneve që nuk i prekin asnjë qime pushtetit qendror.

Opozita duhet të dijë të vetësakrifikohet që të ketë moralin për t'u kërkuar njerëzve sakri-

ficën e tubimit përreth saj.

Përndryshe, kot i shpenzon energjitë, kot i harxhon paratë e autobusëve dhe kot i shpërdoron kaloritë e marshimit në bulevard.

Nëse përfundimi i këtij aksioni të shpallur papritmas, pas një beteje të munguar në Kuvend, është kthimi kokulur në atë sallë ku miratohen ligje antikushitetuese dhe ku askush nuk ia vërshejllën zërvanë opozitarë; nëse ai do të kulmojë në rendjen me brirët ngritur, pas bezes së kuqe të zgjedhjeve, më mirë le të ndalë që tani.

Sepse po vazhduan kështu, jo vetëm që nuk do të arrijnë qëllimin e premtuar për të rrëzuar Ramën, por do t'i shërbejnë atij si fasadë, për të na thënë ne të tjerëve, opozitës shumë më të madhe se ajo zyrtare, se ai del gjithnjë fitimtar; në këtë vend demokratik, me garë dhe kundërshtarë të fortë.

HOROSKOPI

DASHI
Të lindurit e kësaj shenje rekomandohen të shmangin pjesëmarrjen nëpër konflikte. E vërteta nuk mund të vërtetohet ende, pavarësisht argumenteve bindëse. Sot ka gjasa të eksperimentoni me një stil të ri. Sa i përket çështjeve financiare, një situatë e çuditshme mund t'ju krijojë.

DEMI
Gjendja juaj emocionale do të luhatet nga një skaj në tjetrin. Përpikuni të kontrolloni veten nëse keni një prezantim, raportim publik apo ndonjë bisedë të rëndësishme për të bërë. Në mbrëmje do të krijoni kontakte të reja.

BINJAKET
Binjakët do ta mbajnë mend gjatë kësaj dite. Do të ndodhë një mrekulli. Do të jeni i rrethuar nga magjia. Mos harroni të mendoni një dëshirë të rëndësishme. Në të njëjtën kohë duhet të keni besim në vetetë për çdo gjë që kalidhe me ju.

GAFORJA
Do të përshiheni nga pesimizmi, i cili nuk do t'ju ndikojë aspak mirë në gjendjen tuaj emocionale. Mos i lejojnë të tjerët t'ju kontrollojnë. Ndajini problemet tuaja vetëm me të afërmit dhe pasi ta bëni këtë do të ndiheni shumë më mirë.

LUANI
Sot nuk do të keni dëshirë të punoni. Ka gjasa të bëni një pushim të paplanifikuar. Nëse do t'iu duhet pajtësi të shkoni në punë, përqendrohuni tek gjërat pozitive. Disa prej jush do të gjejnë një drejtim të ri në biznes. Do të bëni mirë ta kaloni mbrëmjen me të afërmit tuaj.

VIRGJERESHA
Disa persona të kësaj shenje do të kenë nevojë për ndihmën e një specialisti. Mund të mos ndiheni mirë nga ana shëndetësore. Megjithatë, kjo vlen vetëm për pjesën e parë të ditës, pasi gjatë pasdites do t'ju bëjnë një surprizë.

PESHORJA
Atmosfera gjatë ditës së sotme do t'ju irritojë. Ka shumë mundësi që të keni mosmarrveshje me një nga familjarët ose një nga kolegët. Gjatë ditës do të kryeni disa blerje të rëndësishme. Mbrëmja do t'ju kalojë pa probleme emocionale.

AKREPI
Akrepet do të ndihen shumë të kënaqur sot. Do të keni sukses në disa fusha të jetës. Nxitimi është i papranueshëm në marrëdhënien tuaj të dashurisë. Përpikuni t'i rezistoni tundimit në gjysmën e dytë të ditës.

SHIGJETARI
Shigjetarët do të rrisin interesin për çështjet familjare. Vetëm ju do të mund t'i jepni zgjidhje problemeve. Në mbrëmje do të bëheni shumë romantik. Shigjetarët beqarë mund t'i rikthehen dashurisë së vjetër.

BRICJAPI
Bricjapët mund të shqetësohen për shëndetin sot, megjithatë nuk bëhet fjalë për asgjë serioze. Do të keni dëshirë të bëni shopping ose të shkoni në ndonjë zonë relaks. Bëni kujdes nga disa persona që i rrethojnë në punë.

UJORI
Mund të realizoni një udhëtim të papritur, i cili do t'ju falë shumë kënaqësi. Do të keni mbështetje për idetë tuaja të reja. Mos kryeni shpenzime për gjëra të cilat mund përdoheni më pas.

PESHQIT
Peshqit mund të debatojnë me familjarët për disa probleme të vogla në shtëpi. Bëni të pamundurën për t'i vendosur gjërat nën kontroll me shpejtësi. Do të ishte mirë ta shpenzonit këtë të premtën larg shtëpisë.

SULMUESI ANGLEZ I TIRANËS

Në Kategorinë e Parë ishte lider te Tirana, ndërsa i rikthyer pas dëmtimit, këtë sezon në Superiore kur pritej që të bënte shumë, duket se nuk po ja del. E madje nuk i ka luajtur të gjitha ndeshjet si titullarë. Ky është shtatlarti anglez, Majkëll Ngo, i cili për "Rt-shsport", ka pohuar: "Faza përgatitore po shkon mirë, po stërvitemi intensivisht



dhe ecuria është pozitive. Tani kemi nevojë të jemi të bashkuar si skuadër dhe të rrisim performancën në

Ngo: Ja raporti im me Memën, mos më krahasoni me Balotelin

ndeshjet e ardhshme. Unë personalisht mundohem që të jap më të mirën. Nuk është në natyrën time që unë të bëj debate apo sherre, në fushë apo jashtë saj". Lidhur me marrëdhëniet që anglezi ka me trajnerin Mema, ku shpesh është folur edhe për përplasje mes tyre, shtatlart-

soj se marrëdhënia me Memën është brilante. Jam i lumtur që e kemi në krye të pankinës". Kur e krahasojnë me Balotelin, ai të përgjigjet prerazi: "Jo aspak, nuk ngjasoj me askënd dhe mundohem që të jem vetvetja kudo. Dua që të jap më të mirën, Tirana të fitojë dhe të eci sa më mirë, sepse prandaj kam ardhur në Tiranë nga Anglia", - tha ndër të tjera sulmuesi shtatlartë i bardhebluve.

ISH-LOJTARI INAPOLI



Ieko: Hysaj nuk është për formacionin titullar

Eiseid Hysaj nuk po kalon ditët e tij më të mira te Napoli. Shqiptari ishte në formacion ndeshjen e fundit për Kupën e Italisë ndaj Sasuolo, por atij i duhet të luftojë shumë për të pasur pëlqimin e Ancelotit. Ish-lojtari i Napolit përgjatë viteve 2005-2011, Xhenaro Ieko, ka disa kritika për mbrojtësin e djathtë. "Hysaj nuk mendoj se është i përshtatshëm për të qenë titullar te Napoli. Është lojtar i mirë për të qenë pjesë e grupit, por nuk është aq sa për të qenë nga minuta e parë", u shpreh ish-portieri, i cili edhe pse për 6 vite lojtar i skuadrës jugore të Italisë, numëron vetëm 25 paraqitje, madje duke mbajtur edhe shiritin e kapitenit në disa takime.

Me afrimin e Rocës dhe Shkurtajt, skuadra është bërë më e fortë, por mbrojtësi pret ende përf forcime



Jeton Selimi

Shameti: Duam titullin, s'ka çështje "Rexhinaldo"

Kapiteni i Kukësit analizon gjysmën e parë të sezonit

Dy fitore dhe një humbje përballë skuadrës që kryeson kampionatin turk Istanbul Basaksehir. "Më mirë se kaq nuk mund të bëhej" kjo shprehje e njohur në zhargonin e përditshëm i shkon përshtat fazës përgatitore të Kukësit në Antalya. Kushtet optimale, asnjë dëmtim, stërvitje me ritëm të lartë dhe paraqitje shumë të mira në miqësore. Blutë e mbyllën këtë periudhë të rëndësishme po ashtu si përfunduan fazën e dytë, me ADN-në e një skuadre fituese. Kapiteni Ylli Shameti pavarësisht se nuk shquhet për deklaratat euforike, nuk gjen asnjë aspekt negativ në mënyrën se si Kukësi zhvilloi përgatitjet në Turqi. "Kemi bërë një fazë përgatitore në kushte optimale. Nuk është viti i parë që shkojmë. Fushat ishin shumë të mira, si dhe zhvilluam miqësore me ekipe shumë të forta. Logjikisht këto miqësoret nuk janë në nivelin e ndeshjeve zyrtare, por shpresoj të nandhmojnë në kolaudimin e skuadrës dhe fillimin sa më të mirë të 2 fazave të mbetura të kampionatit", deklaroi Shameti për "Supersport".

Vasil Shkurtaj, Eduart Rocca, dy goditje që kanë ndikuar në cilësinë e skuadrës. Shameti ka pasur mundësinë t'i sfidojë si kundërshtarë dhe është i ndërgjegjshëm për potencial-



in e dy prurjeve të reja, ka vetëm një pengesë që mund të ngadalësojë ritmin e tyre, përshtatja me lojën e Kukësit. "Çdo lojtar ka nevojë për t'u përshtatur. Vijnë në ekip tjetër. Gjëja e mirë është që janë të 2 shqiptarë, e njohin kampionatin, kanë luajtur këtu. Me cilësitë e tyre besoj

se do na ndihmojnë shumë. Shpresoj të integrohen dhe të bëhen bashkë me ekipin sa më shpejtë. Besoj do jenë 2 blerje të goditura që do na ndihmojnë në fund për arrijtjen e objektivave". 34-vjeçari është një lider jo vetëm në fushë por edhe në dhomat e zhvëshjes, Reginal-

do ngjan si i "divorcuar në shtëpi", por për kapitenin nuk ka asnjë çështje. "Ne jemi lojtarë dhe askush nuk e pranon stolin. Kjo është një gjë e mirë. Pasi një lojtar që pranon stolin, tregon që nuk mund të presësh shumë nga ai. Rexhinaldo ka bërë mirë. Nuk ka pasur një sulmues tjetër në


krahë që të rritej konkurrenca. Patjetër që tani me Shkurtajn konkurrenca është rritur. Mendoj që e vendos stafi teknik se kush do zbresë në fushë. Të 2 do të jenë shumë të nevojshëm për ekipin. Nuk mendoj që ka një çështje "Rexhinaldo". E rëndësishme është që të gjithë të bëjnë maksimumin, në fushë në stol, apo në tribunë". Merkato ende nuk e ka thënë fjalën e fundit, çdo afirmim është i mirëpritur, megjithatë ndonjëherë ekuilibrat e skuadrës kanë më shumë vlerë se sa një futbollist i ardhur në janar. "Sa më shumë lojtarë të kesh aq më mirë është. Ndonjëherë të kthehen edhe kundër. Nëse merr lojtarë të mirë, të gjithë duhet të luajnë. E mos kesh lojtarë, prapë keq. Në qoftë se vjen ndonjë lojtar që mund të na shërbejë është i mirëpritur". Ditët e fundit të përmendësh tek Kukësi objektiv tjetër përveç titullit është mëkat, investimet e kanë dërguar në qiell presionin për trofeun, në lidhje me këtë Ylli Shameti e ka një mesazh për shokët e

skuadrës. "Kukësi gjithmonë ka bërë investime për titullin kampion. Të paktën këto 3-4 vitet e fundit. Të gjithë lojtarët duhet të dinë se ku vinë. Duhet të njohin presidentin dhe objektivat. Po të jesh lartë presioni është më i madh. Vërtet kemi bërë shumë gabime në 2 fazat e para. Kemi rikuperuar në dy të tjerat".

5 mln euro kartoni i Zenelit

Çelsi, shumë pranë talentit shqiptar të Kosovës

Një lajm i bujshëm është duke qarkulluar në mediat italiane dhe jo vetëm. Bëhet fjalë për shqiptarin e Kosovës, Arbër Zeneli. Mesfushori 23-vjeçar ka zgjatur interesin e gjigantëve të Çelsit dhe pëlqehet nga trajneri Sarri. Zeneli aktualisht është pjesë e Herenvenit në Holandë, tek sa po kalon një moment mjaft të mirë. Në pjesën e parë



të sezonit mesfushori i përfaqësues së Kosovës arriti të shënonte 4 gola dhe regjistroi 10 asistime, duke u shndërruar në një lider te skuadra holandeze. Kësisoj, futbollisti është në listën e dëshirave të klubit anglez, teksa këta të fundit janë të gatshëm të paguanë 5 milionë paund për shërbimet e 23-vjeçarit.

Dështimi i madh i Milanit


Një gol i Gonzalo Higuain vlen 2 milionë euro

Gonzalo Higuain nuk po bind aspak me Milanin këtë sezon. Edhe pse kuqezinjët e priten mirë dhe me entuziazëm, ai deri më tani rezulton një dështim për italianët. Faktet flasin vetë, shifrat nuk janë pro argentinasisit dhe kjo duket. Deri në këtë pikë të sezonit, ai ka shënuar 8 gola në 22 ndeshje. Gjashtë prej tyre i ka shënuar në kampionat ndërsa dy të tjerat në Ligën e Europës. Deri në këtë fazë të sezonit ai i ka kushtuar Milanit, plot 17.5 milionë euro. Tek kjo



shifër përfshihen paga e tij dhe huazimi nga Juventus. Çdo gol që ai ka shënuar ka kushtuar 2.187.500 euro, ndërsa çdo ndeshje të luajtur 795 mijë euro. Nëse do të marrim parasysh dëmtimet, kartonin e kuq dhe një penallti e humbur kundër Juventusit, atëherë mund të themi që kjo blerje ka rezultuar dështim për kuqezinjët.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Bëjnë artet me re.
- Krijoi Arsene Lupin (inic).
- Janë forma.
- Në hyrje të plazhit.
- Kapen të parat.
- Janë ufot.
- Mbahen nga ata që i theyejnë.
- Inicialet e Mascagni-t.
- Në krye të trupave.
- Është edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- Pak hemorragji.
- U shkrua nga Jack London.
- Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- Scarlet e Bashkë me erën.
- Janë tituj në ekran.
- Eric aktor.
- Kështu e ka syrin vigjilent
- Janë nofka.
- Një provë... inteligjence.
- Mund të jenë me sahat.

- Një pjesë e naivitetit.
- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohet nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prin kolonës.
- Është filozofie moralit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Carnera, ish-kampion i ringut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrënjët në tokë.
- Është pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Është kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushatat.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjëherë duhen vënë mbi i.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Është nënë e Tironës.
- Është shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari spiuane.
- Qyteti i Robespierre.
- Phineas i famshëm i cirkut.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Është shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Pak iniciativë.
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.
- Veriu pa kufij.
- Mbyllin një tender.

VERTIKAL:

- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaj.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë
- Është edhe ai i sheqerit.
- Është lloj papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë.
- Është pluhuri si Dash.
- Është e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Është për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
- Provinca e boerëve.
- Është qyteti i njëmbinjë dritareve.
- Është dukuria.
- Është hidrokarbur.
- Griffith aktore.
- Qe perëndesha e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon çmimin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Është princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerante.
- Modem pa zë.
- Pak marramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

7			8		5					
1	6		7	4						9
3		8		2						
2	7		3		9					
			5	4				3		
			9		5			6		2
			1		3					4
										5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	4	2	9	7	5	3	1	6		
5	6	9	8	1	3	4	7	2		
1	3	7	2	4	6	8	9	5		
6	8	5	1	9	4	2	3	7		
7	1	4	6	3	2	9	5	8		
9	2	3	5	8	7	6	4	1		
4	7	8	3	2	1	5	6	9		
2	5	1	4	6	9	7	8	3		
3	9	6	7	5	8	1	2	4		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

- Dallimi i teorisë nga praktika, është shumë i vogël në teori, por shumë i madh në praktikë.

- Para se të kërkonit atë që u tha në lidhje me ju, mësoni se kush e ka thënë atë. E dyta është më e rëndësishme dhe përcakton vlerën dhe rëndësinë e të parës.

- Ëndrrat janë si mrekullitë. Dalin të vërteta vetëm kur ju i besoni ato.

- Gjithçka që fillon me siguri, përfundon me dyshim.

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19
6	4	1	3								
13											
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3	14	4
19											
8	11	1									
3	2	10	3	2	11	6					
18	8										
15	2	3	2	11	2	11	6	5	10	5	3
5	3	2	14	2	3						

B A S T E T P A P A
U R A T U R H P A
S A M M A R A I N I
T A M E R I K A N E T
P R O T E S T A N T E T
G J I G A N T I I R R
B E T O N E K B O A T
S A L I R A M A E
G O N T I T U L L A R
A R E S A O E N E
Z J A R Z O T I M E T
I A M E R E N G U E S

Thënie të mençura

- Asgjë nuk është më subjektiv se sa plotësisht objektiv ...
- Krenaria merret me "kush ka të drejtë". Mençuria merret me "çfarë është e drejtë".
- Njohurinë e pasaktë gjithmonë e ndjek një vendim i gabuar.
- Ateistët janë njerëz të veçantë. Duhet më shumë besim për t'u bërë ateist se sa fetar.
- Pothuajse të gjithë ateistët kanë argumente për bindjet e tyre. Pothuajse asnjë fetar nuk ka argumente për bindjet e tij.

